



**RAPORT DY MUJOR NGA MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME DHE
DIASPORËS PËR KRYEMINISTRIN Sh.T.Z. AVDULLAH HOTI**

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës

10, Gusht, 2020

PËRMBAJTJA:

| | |
|--|----|
| HYRJE | 2 |
| GJENDJA NË TË CILËN ËSHTË GJETUR MINISTRIA E JASHTME DHE DISASPORËS (MPJD), NË FILLIM TË MANDATIT | 3 |
| RAPORTI PËR PUNËN PESËDHJETË (50) DITORE | 8 |
| PLANI I PUNËS SIPAS DEPARTAMENTËVE TË MPJD-së DHE SFIDAT | 18 |
| PËRFUNDIME | 46 |

HYRJE

Në kuptim të nenit 69 paragrafi 4 (1) dhe të shtojcës II pika 5 (Komisioni për Punë të Jashtme) të Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës (29 prill 2010), si dhe bazuar edhe në praktikën e mëhershme, duke pasur parasysh rëndësinë e bashkëpunimit, për nevoja të komisionit parlamentar për Punë të Jashtme dhe Diasporë, paraqesim këtë raport me shkrim.

Përmbajtja e raportit është e nivelit të kufizuar, andaj kërkojmë nga ju, si anëtarë të komisionit që këto informacione të trajtohen me kujdes, për shkak të rëndësisë që kanë dhe me qëllim të ruajtjes nga ndërhyrjet eventuale të proceseve që kanë shumë rëndësi për Republikën e Kosovës.

Raporti i dorëzohet vetëm anëtarëve të komisionit.

Përmbajtja e raportit është e ndarë në tri pjesë, si vijon:

- I. Gjendja në të cilën është gjetur Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës-MPJD, në fillim të mandatit;**
- II. Puna pesëdhjetë (50) ditore në MPJD;**
- III. Plani i punës sipas departamenteve të MPJD-së.**

Me respekt,

Meliza Haradinaj-Stublla

Ministre e Punëve të Jashtme dhe Diasporës

PJESA E PARË

I. GJENDJA NË TË CILËN ËSHTË GJETUR MINISTRIA E JASHTME DHE DISASPORËS (MPJD), NË FILLIM TË MANDATIT

Si pjesë e parë e këtij raporti është qartësimi i gjendjes se si është gjetur Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD), me rastin e marrjes së detyrës së Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Znj. Meliza Haradinaj-Stublla.

Disa çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me gjendjen e në të cilën Ministria e MPJD-së, e ka pranuar detyrën me datë 5 Qershor 2020 janë si në vijim:

1. Mosdorëzimi i detyrës nga ish Ministri

Ministrja e MPJD-së, Znj. Meliza Haradinaj Stublla ka marrë detyrën me datë 5 Qershor 2020. Ditën e pranimit të detyrës, pas votimit të qeverisë në Kuvend, Ministria është pritur vetëm nga stafi i protokollit të shtetit dhe UD Sekretari i MPJD-së. Pasiqë nuk është bërë pranim dorëzimi i detyrës, ashtu siç do të duhej sipas praktikës institucionale, Ministria e MPJD-së, Meliza Haradinaj Stublla nuk ka pasur asnjë informacion zyrtar nga ish Ministri për gjendjen në politikën e jashtme dhe në shërbimin e jashtëm.

Për më tepër, duke mos pasur asnjë raport me shkrim nga ish Ministri për gjendjen e MPJD-së, janë gjetur shumë parregullsi, duke filluar nga çështjet më elementare. Kanë munguar shkresat zyrtare sipas evidencës në librin e protokollit, kanë munguar vendimet e nxjerra, sipas evidencës së librit të protokollit, zyra ka qenë në mënyrë jo të rregullt, duke përfshirë këtu edhe çështjen e sefit në zyrën e Ministres. Për çështjen e sefit Ministria e MPJD-së, ka formuar komision të veçantë, ku në përbërje ka qenë edhe një anëtar nga AKI.

Kjo praktikë e mos dorëzimit të detyrës, ka ngadalësuar jashtëzakonisht shumë punën e Ministres së MPJD-së, pasi që shumë dokumente dhe informacione të munguara, të cilat do të duhej të dorëzoheshin nga Ish Ministri, sipas obligimit institucional janë gjetur në rrugë jo zyrtare dhe më të vështira. Një praktikë e tillë përbën qasjen më të keqe të mundshme ndaj institucioneve të Republikës së Kosovës.

2. Jo funksionaliteti i shërbimit të jashtëm

Pas marrjes së detyrës nga Ministria e MPJD-së, gjendja në shërbimin e jashtëm ka qenë tërësisht jo funksionale. Në këtë aspekt vlen të theksohet që ish Ministri nuk e ka bërë asnjë hap drejt fuzionimit të dy Ministrive, asaj të Jashtme dhe të Diasporës. Për këtë proces, janë krijuar dhe ndryshuar tri (3) herë grupet punuese, pa pasur asnjë rezultat konkret.

Procesi i rotacionit ka qenë vetëm një improvizim. Edhe pse është proklamuar si i suksesshëm, rotacioni nuk ka pasur asnjë rezultat. Madje sipas raportit nuk janë rekomanduar shumë diplomatë që janë kompetent për të shkuar në misione dhe kanë performancë të lartë të punës në shërbimin e jashtëm.

Ka pasur një numër të madh të vendimeve për kthim, të cilët janë marrë vetëm për efekt politik, në kohën kur qeveria ka qenë e shkarkuar. Këto vendime për kthimin e diplomatëve të karrierës, janë marrë pa bërë asnjë analizë paraprake të nevojave dhe kjo gjë ka bërë shërbimin e jashtëm krejtësisht jo funksional. Kjo edhe për arsye se dërgimi i njerëzve në mision nuk ka qenë në përputhje me kthimin, sepse kthimi është bërë krejtësisht me motive politike dhe për efekt elektoral. Sidomos jo funksionale janë lënë misionet diplomatike në vendet e Kuintit.

Sa më sipër, për këtë arsye, Ministrja e MPJD-së është dashur të analizojë edhe njëherë rast për rast të gjitha vendimet, në mënyrë që të rikthejë funksionalitetin e shërbimit të jashtëm, të dëmtuar nga ish Ministri.

3. Aplikimi i standardeve selektive me rastin e nxjerrjes së vendimeve

Në vendimet e realizimit të rotacionit për kthim, nga ish Ministri Konjufca është vërejtur një qasje e theksuar e standardeve selektive, me rastin e nxjerrjes së vendimeve. Ka pasur raste kur janë kthyer diplomatë nga misioni, por ka pasur edhe raste tjera kur për të njëjtat standarde, diplomatë të caktuar kanë qëndruar në misione diplomatike pa u kthyer në MPJD, gjithnjë sipas vendimeve të ish Ministrit Konjufca, aq shumë të proklamuar si të “suksesshme”. Këto standarde selektive janë zbuluar pas analizimit të vendimeve rast për rast nga komisioni i krijuar nga Ministrja e MPJD-së. Shpjegimin për këto standarde selektive do të duhet ta jap vetëm ish Ministri dhe kabineti i tij.

Po ashtu, në mënyrë jo të bazuar në ligj, i është shkëputur marrëdhënia e punës diplomatëve që kanë punuar në shërbimin e jashtëm për më shumë se shtatë (7) vite. Raste të tilla të vendimeve selektive janë të analizuara rast për rast, me qëllim që të sanohet dëmi i pariparueshëm që mund ta shkaktojë zbatimi i këtyre vendimeve.

4. Tërheqja nga aplikimi në INTERPOL

Ish Ministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Glauk Konjufca, në mbledhjen e parë të qeverisë kishte marrë vendimin për të stopuar kërkesën e Kosovës për anëtarësim në Interpol në përputhje me kërkesën e Serbisë për të pasur një moratorium për anëtarësimin e Kosovës në Interpol dhe UNESCO. Asambleja e Përgjithshme e UNESCO-s nuk do të organizohet këtë vit pasi mblidhet çdo 2 vjet, kështu që vetëm Interpol ishte në agjendën multilaterale të Kosovës. Beogradi ka kërkuar vetëm ndalimin e anëtarësimit në Interpol dhe UNESCO, këtë mund ta shihni nga deklaratat e Ivica Daçiçit. Ish Ministri Konjufca dhe qeveria e tij e pranuan këtë kërkesë në mbledhjen e parë të kabinetit qeveritar.

5. Mungesa e planit për njohje dhe aderime

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës për herë të parë që nga shpallja e pavarësisë u tërhoq nga lobimi për njohjen e Kosovës, gjatë mandatit të ish-Ministrit Konjufca. Asnjë veprim nuk është ndërmarrë për të komunikuar më vende të ndryshme. Asnjë strategji apo plan veprimi nuk është formuluar se si të adresohet njohja e Kosovës dhe asnjë komunikim me vendet jashtë Evropës nuk është bërë nga ish-ministri Konjufca. Asnjë letër e vetme që kërkon njohjen e Kosovës nuk është dërguar nga ish-Ministri Konjufca.

6. Tërheqja e përfaqësuesit të Republikës së Kosovës nga NATO

Ish Ministri i MPJD-së, ka dërguar shkresë për tërheqje të përfaqësuesit të Republikës së Kosovës në NATO, të emëruar me dekret të Presidentit në vitin 2019 me mandat 4 vjeçar. Me këtë veprim në vend se qeveria e kaluar t'i avanconte raportet me NATO-n, me tërheqjen e përfaqësuesit tonë pranë kësaj organizate, ata kanë bërë hapa mbrapa, duke e dëmtuar Republikën e Kosovës dhe raportin e saj në politikën e jashtme. Me këtë veprim po ashtu është kthyer mbrapa raporti që Republika e Kosovës, e ka ndërtuar me NATO-n, në kuptim të avancimit të pozitës dhe intensifikimit të aktiviteteve më këtë organizatë.

7. Defunksionalizimi i misioneve diplomatike në vendet e Kuintit dhe në Hagë

Përmes tërheqjes së diplomatëve nga misionet diplomatike, pa standarde dhe pa kritere objektive, ish Ministri Konjufca, e ka defunksionalizuar në tërësi shërbimin e jashtëm.

Vendimet e pa analizuara mirë, të kthimit të diplomatëve të marra nga Ish Ministri Konjufca, kanë defunksionalizuar në tërësi misionet diplomatike në vendet e Kuintit. Me theks të veçantë këtu duhet përmendur misionet diplomatike dhe konsullore në ShBA (Uashington dhe Nju Jork) si dhe në Paris. Nga analiza e bërë të vendimeve të ish Ministrit (rast për rast), ka rezultuar që ish ministri nuk e ka ndërmarrë asnjë hap në përmirësimin e gjendjes, ani pse vendimet e tij qartazi kishin krijuar një pasojë të defunksionalizimit të shërbimit të jashtëm në vendet e Kuintit.

Në veçanti duke defunksionalizuar misionin diplomatik në Hagë, pikërisht në kohën kur është nevojitur funksionalizimi i plotë i këtij misioni për shkak të zhvillimeve në raport me proceset në dhomat e specializuara. Një veprim i tillë tregon qasjen e nxjerrjes së vendimeve për kthim, pa planifikuar mirë dhe me kritere objektive, në raport me misionet diplomatike. Qasja e tillë e ish Ministrit të MPJD-së, ka prodhuar jo funksionalitet të misioneve, në raport me nevojat që kemi, kriter ky i cili është më i rëndësishmi kur vlerësohet kthimi ose dërgimi i diplomatëve në misione diplomatike.

8. Pozicioni i dëmtuar i Republikës së Kosovës në raport me Serbinë, pas heqjes së taksës dhe në prag të rifillimit të dialogut

Qeveria e Albin Kurtit dhe ish-ministri Konjufca kanë dëmtuar interesat kombëtare të Kosovës, kur ata hoqën taksën e tregtisë të vendosura ndaj Serbisë dhe Bosnjë e

Hercegovinës. Me Serbinë, ata hoqën dorë nga argumenti i Kosovës se Serbia është shteti destruktiv dhe i duhet të përfundojë agresionin diplomatik kundër Kosovës. Qeveria Kurti hoqi taksën ndaj Serbisë pa marrë asgjë në këmbim, kështu që ata ndihmuan që argumentet e Serbisë të fitojnë se Kosova ka vendosur tarifën jo si një kundër-masë ndaj agresionit diplomatik serb, por sepse është një shtet jokonstruktiv në rajon. Me këtë veprim qeveria Kurti e ndihmoi narracionin serb kundër Republikës së Kosovës.

Për Bosnjën, asgjë nuk u fitua në këmbim të heqjes së taksës, as njohjes së pasaportave dhe as heqjes së barrierave tregtare nga Bosnja në Kosovë.

Këto veprime e kanë vendosur në defanzivë të madhe pozicionin e Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare e cila po prodhon pasoja në politikën e jashtme.

9. Ç ‘njohja nga Sierra Leone dhe veprimet tjera që kanë dëmtuar pozicionin ndërkombëtar të Kosovës

Ministri Konjufca është informuar nga stafi i Ministrisë së Punëve të Jashtme, se ai duhet të angazhohet me Sierra Leone dhe vendet e tjera që janë nën presion për tërheqjen e njohjes nga Serbia. Një informacion i tillë nuk është marrë seriozisht dhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim për të parandaluar këtë situatë. Kur Sierra Leone njoftoi tërheqjen e njohjes së Kosovës, asnjë veprim diplomatik nuk është ndërmarrë për ta zhbërë këtë. Ish Ministri Konjufca nuk ka telefonuar homologun e tij të Sierra Leones dhe as nuk ka dërguar ndonjë letër diplomatike. Ambasada e Kosovës në Senegal që është marrë me këtë çështje, nuk është kontaktuar asnjëherë nga Ministri Konjufca ose kabineti i tij për këtë, as nuk janë përgjigjur në kërkesat dhe emailat të Ambasadës në Senegal që kanë kërkuar udhëzime dhe dokumente të tjera.

Po ashtu, Qeveria e Kurti ka ndihmuar Serbinë në pranimin e testeve të covid 19 për të fituar fytyrën humanitare. Në qeverinë e mëparshme nga viti 2017, deri kur Kurti mori pushtetin, Kosova ka punuar për t’i treguar botës fytyrën korruptive dhe kriminale të diplomacisë serbe, çka u pranua nga partnerët tanë shumë vende dhe mediat e huaja, por Kurti, Konjufca, dhe Vitia me një vendim të vetëm kanë hedhur poshtë të gjithë punën e bërë për të treguar fytyrën e vërtetë të Serbisë. Dhe fytyra e vërtetë e Serbisë nuk është humanitare, por kriminale dhe fashiste në raport me Kosovën.

10. Skandali me ‘njohjen’ nga Xhamajka

“Njohja” nga Xhamajka ka qenë njëri nga skandalet e cila ka identifikuar gjendjen në të cilën është gjetur politika dhe shërbimi i jashtëm, përgjatë qeverisjes së kaluar. Veprimet e ish Ministrit Konjufca në raport me këtë çështje nuk kanë qenë asnjëherë të qarta dhe asnjëherë i njëjti nuk e ka sqaruar krejtësisht mënyrën se si ka ardhur deri tek kjo “njohje” apo kjo situatë e krijuar në këtë rast.

Ish Ministri dhe në përgjithësi qeveria Kurti, në mënyrën e reagimit në raport me këtë çështje ka shpërfaqur pa aftësinë, jo profesionalizmin dhe jo kompetencën, sidomos në politikën e jashtme. Për më tepër qasja e tillë ka dëmtuar edhe raportet e Republikës së Kosovës në politikën ndërkombëtare në përgjithësi.

11. Vërejtjet e dhëna për diplomatët të cilët i kanë pëlqyer postimet e Ambasadorit Richard Grenell

Në mënyrë krejtësisht të kundërligjshme, duke mos respektuar asnjë akt ligjor dhe nënligjor, mbi punën në shërbimin e jashtëm dhe në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, është shqiptuar vërejtje për anëtarët e shërbimit të jashtëm, të cilët kanë pëlqyer postimet e Ambasadorit Amerikan Richard Grenell.

Qasja e tillë është kundër ligjore, sepse nuk ka të bëjë aspak me detyrat e punës së një anëtari të shërbimit të jashtëm. Sipas ligjeve në fuqi dhe akteve nënligjore, anëtari i shërbimit të jashtëm mund t'i shqiptohet masa disiplinore vetëm nëse ka shkelur detyrat e tij/saj të punës.

Për më tepër kjo çështje është skandal në vete sepse bëhet fjalë për qasjen ndaj një zyrtari të lartë të ShBA-ve, shteti i cili e ka mbështetur më së shumti Republikën e Kosovës në shtet krijim dhe shtet ndërtim.

PJESA E DYTË

I. RAPORTI PËR PUNËN PESËDHJETË (50) DITORE

Duke pasur parasysh gjendjen në të cilën është gjetur MPJD dhe shërbimi i jashtëm, pas marrjes së detyrës, Ministria e MPJD-së, Znj. Meliza Haradinaj Stublla ka pasur një agjendë të ngjeshur duke u marrë më çështjet më elementare të mundshme e deri me ato më të ndërlikuara në politikën e jashtme, për shkak të dëmtimit të pozitës ndërkombëtare të Kosovës nga qeveria Kurti dhe ish Minsitri Konjufca.

Disa nga sukseset dhe angazhimet e pesëdhjetë (50) ditëshit të parë të mandatit të Ministres së MPJD-së, Znj. Haradinaj Stublla janë si në vijim:

1. Rivendosja e komunikimit me SHBA

Pas veprimeve të qeverisë Kurti, është përmirësuar komunikimi institucional në raport me SHBA-të, duke shprehur gatishmërinë për thellim të raporteve dhe intensifikimin në forcimin e lidhjes tonë me aleatin kryesor, i cili na ka mbështetur në çlirim, në shtet krijimin dhe shtet ndërtimin e Kosovës.

Narracioni nga qeveria e kaluar me SHBA-në “thikat mbi hartën e Kosovës në Uashington” ka kaluar në narracion dhe veprime konkrete për punë të përbashkët, me synimin e mbështetjes së Republikës së Kosovës nga SHBA, për konsolidimin e shtetësisë, pozicionit ndërkombëtar dhe reformimin e shërbimit tonë të jashtëm.

Kemi ndërmarrë hapa konkret që të vendosim komunikim me institutin e shërbimit të jashtëm amerikan, me qëllim që shërbimi jonë i jashtëm të përfitojë nga praktika dhe përvoja diplomatike, më shumë se 200 vjeçare e diplomacisë amerikane.

2. Parandalimi i ç ‘njohjeve

Në muajin qershor ka pasur paralajmërime se dy shtete të Paqësorit mund të tërhiqnin njohjen e shtetësisë së Kosovës, mirëpo Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka vendosur kontakt të drehtëpërdrejtë me përfaqësuesit e atyre vendeve, dhe së bashku me aleatët e Republikës së Kosovës, janë marrë veprimet e nevojshme që të parandalohet marrja e ndonjë vendimi të tillë.

3. Rivendosja e kontakteve me shtetet njohëse

Në vazhdimësi ka pasur një neglizhencë ndaj vendeve njohëse të caktuara, me të cilat Republika e Kosovës ka pasur shumë pak apo nuk ka vendosur fare kontakte. Ministrja e MPJD-së, Meliza Haradinaj Stublla, ka filluar të ndërtoj një plan për komunikim intensiv dhe vendosje të raporteve bilaterale konkrete me këto shtete.

Vendosja e kontakteve do të bëhet përmes kanaleve diplomatike si dhe veprimeve të tjera të drejtpërdrejta, ku do të vendosen kontakte dhe të lidhen marrëveshje me shtetet përkatëse, të cilët na kanë njohur por që janë neglizhuar.

Për këtë Ministrja e MPJD-së, është duke përgatitur planin e veprimit se si t'i qaset këtyre shteteve, duke pasur parasysh gjendjen aktuale të politikës së jashtme dhe gjendjen e raporteve të neglizhuara me këto shtete njohëse.

4. Rishqyrtimi i vendimeve të ish Ministrit dhe rivendosja e legjitimitetit në Shërbimin e Jashtëm

Me qëllim të analizimit të bazës ligjore të vendimeve të nxjerra nga ish Ministri Konjufca, Ministrja e MPJD-së, ka themeluar grupin punues *Për themelimin e Grupit Punues për zbatimin e rotacionit “një në shërbim një në ministri” dhe analizimin e ligjshmërisë së vendimeve të Ministrit paraprak të MPJD-së, përkitazi kthimin nga misioni sipas procesit të rotacionit* (vendimi i datës, 22.06.2020). Ky grup punues ka analizuar të gjitha vendimet e nxjerra nga ish Ministri i MPJD-së, për realizimin e rotacionit dhe kthimin e anëtarëve të shërbimit të jashtëm në Ministri. Nga ky grup janë analizuar gjithsej dyzet (40) vendime të ish Ministrit.

Me rekomandim të këtij grupi punues, sipas vendimit nr.259, të datës 30.06.2020, Ministrja e MPJD-së, ka pezulluar për shtatë (7) ditë të gjitha vendimet e ish Ministrit të MPJD-së. Pezullimi është bërë me qëllim të parandalimit të dëmit që mund t'i shkaktohej shërbimit të jashtëm nga nxjerrja e këtyre vendimeve. Dëmi mund të ishte material, për shkak të ankesave të diplomatëve por edhe jo material dhe i pa riparueshëm, për shkak të rrethanave humane të diplomatëve të prekura nga këto vendime. Kjo nënkupton që ish Ministri i MPJD-së, Z. Konjufca, fare nuk i kishte marrë parasysh rrethanat personale të diplomatëve, si dhe gjendjen e misioneve diplomatike në momentin kur i kishte marrë këto vendime.

Fillimisht pezullimi dhe pastaj analizimi i të gjitha vendimeve rast për rast, nga komisioni i krijuar nga Ministrja e MPJD-së ishte bërë me qëllim të kthimit të legjitimitetit dhe legalitetit në rastin e këtyre vendimeve, sepse pjesa më e madhe e vendimeve janë nxjerrë në kohën kur qeveria ka qenë e shkarkuar dhe ish Ministri në dorëheqje.

Nga analiza e vendimeve rast për rast, ka rezultuar që disa vendime kanë qenë të nxjerra në mënyrë të kundërligjshme, sepse nuk kanë marrë parasysh faktet reale që personave që

i është shkëputur marrëdhënia e punës në shërbimin e jashtëm realisht kanë qenë pjesë e shërbimit civil dhe të emëruar me akt emërim me mandat të përhershëm. Këtë fakt e ka konstatuar edhe komisioni i krijuar nga Ministria e MPJD-së. Po ashtu, ajo që bie në sy tek vendimet e ish Ministrit Konjufca është se të njëjtat janë marrë në mënyrë arbitrare dhe pa e analizuar asnjë fakt dhe rrethanë të nxjerrjes së tyre si dhe mbi të gjitha pa pasur një pasqyrë reale nga një komision paraprak profesional dhe duke mos u bazuar në faktet reale të dosjes së personelit të secilit rast.

5. Procesi i rotacionit sipas parimit “një në shërbim një në ministri”

Nga dyzet (40) vendime të pezulluara të ish Ministrit Konjufca, 35 vendime janë zgjidhur në afat prej 7 ditësh. Nga kjo zgjidhje 35 diplomatë nga ky vendim që janë pezulluar do të kthehen me datë 30.08.2020.

Për pesë (5) vendime, nga vendimet e pezulluara është shtyrë pezullimi derisa të zgjidhen çështjet ligjore që implikojnë këto pesë (5) vendime. Këto pesë (5) vendime janë me bazë të diskutueshme ligjore. Nga numri i përgjithshëm i diplomatëve deri në fund të vitit në MPJD do të kthehen 50 diplomatë, ku në mesin e tyre janë edhe 35 diplomatët që do të kthehen me datë 30.08.2020.

Procesi i rotacionit ka vazhduar në fazën e dytë. Kjo fazë është në finalizim e sipër dhe ka të bëjë me rotacionin e diplomatëve, të cilët do të shkojnë në misione diplomatike për t'i plotësuar vendet vakante, të cilat kanë mbetur pas nxjerrjes së vendimeve për kthim. Ashtu siç e kanë përcaktuar aktet nënligjore të MPJD-së dhe shërbimit të jashtëm, komisioni i krijuar nga Ministria e MPJD-së, që nga data 10.07.2020, deri me datë 23.07.2020, ka **takuar të gjithë diplomatët (anëtarët e shërbimit të jashtëm) të cilët kanë grada diplomatike**, për të marrë preferencat, synimet e tyre për të dhënë kontributin në shërbimin e jashtëm, respektivisht në misionet diplomatike dhe konsullore.

Ndonëse konsultimi paraprak me diplomatët është obligim, sipas akteve nënligjore të MPJD-së, për herë të parë është aplikuar si standard nga Ministria e MPJD-së. Kjo mënyrë e aplikimit të rotacionit është bërë me qëllim të realizimit të një procesi sa më objektiv, transparent dhe me kritere objektive dhe të matshme, duke analizuar në përpikëri nevojat e shërbimit të jashtëm. Raporti i grupit punues për rotacionin e diplomatëve (dërgimi në mision) është dorëzuar tek Ministria e MPJD-së, me datë 27.07.2020.

Po ashtu, në kuadër të këtij procesi, një sukses i theksuar është krijimin i **kalendarit të rotacionit** i cili do të mbetet në personelin e MPJD-së dhe aplikimi i tij do të bëhet i obligueshëm.

6. Riorganizimi dhe ri organizimi dhe ri funksionalizimi i shërbimit të jashtëm dhe MPJD-së

Siç është thënë në pjesën e parë të këtij raporti, procesi i ri organizimit ka qenë një dështim i qeverisë së kaluar. Në këtë aspekt nuk është bërë asnjë përparim, madje në kohën e ish Ministrisë janë ndryshuar tri herë grupet punuese përkitazi me këtë çështje.

Ditët e para të mandatit të saj, Ministria e MPJD-së ka krijuar grupin punues për ri organizim, i përbërë nga njëmbëdhjetë (11) anëtar, të cilët janë duke udhëhequr këtë proces. (Vendimi nr.224, datë 15.06.2020).

Grupi punues për ri organizim është duke përparuar me intensitet të shpejtë. Ky grup me datë 24.07.2020, kanë finalizuar organogramin e ri të MPJD-së, kurse deri me datë 01.08.2020 do të hartojnë draft rregulloren e re për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në MPJD. Rregullorja planifikohet të finalizohet nga data 1 deri me 15 Gusht 2020.

Faza e tretë e ri organizimit dhe bashkimit të dy Ministrive, asaj të Jashtme dhe Diasporës do të mbyllet brenda muajt shtator 2020, ku të gjithë të punësuarit do të sistemohen sipas organogramit të ri të MPJD-së.

7. Grupet punuese për ri funksionalizim

Në kuadër të ri organizimit dhe ri funksionalizimit, Ministria e MPJD-së ka krijuar disa grupe punuese. Dy grupet kryesore punuese janë:

1. Grupit Punues për analizimin e legjislacionit primar dhe sekondar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe identifikimin e nevojave për ndryshim dhe rishikim (vendimi datë, 30.06.2020);
2. Grupi punues për çështje bilaterale (vendimi datë, 30.06.2020).

Të dyja këto grupe janë duke analizuar çështjet të cilat janë në fushëveprim të tyre, me qëllim që të ketë një proces sa më të thellë të ri organizimit dhe ri funksionalizimit të MPJD-së dhe shërbimit të jashtëm në përgjithësi.

Në kuadër të reformave legjislative në shërbimin e jashtëm parashihet të realizohen:

1. Projekt ligji i ri për Shërbimin e Jashtëm;
2. Inicimi i koncept dokumentit për hartimin e një ligji të ri për Marrëveshjet Ndërkombëtare;
3. Rregullorja e re për shërbimin e Jashtëm;
4. Rregullorja e re për organizimin dhe funksionimin e misioneve diplomatike dhe konsullore;
5. Rregullorja për trajtimin financiar të diplomatëve, sipas kostos së vendit pritës;
6. Rregulloret e reja për personelin vendor, teknik dhe shërbyes në misione diplomatike;
7. Rregullorja e re për Akademinë Diplomatike;
8. Rregullorja e re për Institutin Diplomatik.

Kjo reformë legjislativë bëhet me qëllim të ri funksionalizimit të shërbimit të jashtëm, duke synuar profesionalizmin, objektivitetin dhe pa anshmërinë dhe de politizimin e shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës.

8. Takimet dhe vizitat e deritanishme të Ministres

Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Znj. Meliza Haradinaj-Stublla, gjatë punës së saj të deritanishme në MPJD, ka zhvilluar takime, vizita, biseda telefonike dhe video konferenca si në vijim:

- Ka zhvilluar 40 takime fizike në MPJD dhe jashtë saj;
- Ka zhvilluar 12 biseda telefonike dhe
- Ka zhvilluar 11 video konferenca.

8.1.Takimet

- Pritja e Kryeministrit Z. Avdullah Hoti;
- Takim me të dërguarin special të BE-së për dialogun Kosovë-Serbi, Z. Miroslav Lajçak;
- Takim me Ambasadorët e vendeve të BE-së dhe kryeministrin Hoti;
- Takim me Ambasadorin e Gjermanisë Z. Christian Heldt;
- Takim me Ambasadorin e Shqipërisë në Kosovë Z. Qemal Minxhozi;
- Takim me Ambasadorin e Italisë në Kosovë, Z. Nicola Orlando;
- Takim me Ambasadoren e Francës në Kosovë, Znj. Marie Christine Butel;
- Takim me Ambasadorin e Turqisë në Kosovë, Z. Cagri Sakar;
- Takim me Ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Z. Nicholas Abbott;
- Takim me Ambasadorin e Hungarisë, Z. Márkus László;
- Takim me Koordinatorin për zhvillim të OKB-së në Kosovë Znj. Ulrika Richardson;
- Takim me të ngarkuarin me punë në Ambasadën e Japonisë në Kosovë Z. Ogasaewara Mitsunori;
- Takim me Ministrin e Mbrojtjes, Z. Anton Quni;
- Takim me Ambasadoren e Izraelit me mision në Beograd, Z. Alona Fisher-Kamm;
- Takim i përzemërt dhe përmbajtësor me Ministren e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Znj. Vlora Dumoshi.
- Takim me Ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, Z. Jorn Rohde.

8.2.Bisedat Telefonike

- Bisedë telefonike me Z. Matthew Palmer, Zëvendës-Ndihmës Sekretar i ShBA-ve dhe Përfaqësues Special për Ballkanin Perëndimor;
- Bisedë telefonike me ish Sekretaren e shtetit Znj. Madeleine Albright, dhe ish Komandantin Suprem të Forcave Aleate të NATO-s në Evropë Gjeneralin Z. Wesley Clark;
- Bisedë telefonike me homologun nga Shqipëria, Z. Gent Cakaj;
- Bisedë telefonike me homologun nga Turqia Z. Mevlüt Çavuşoğlu;
- Bisedë telefonike me homologun nga Austria Z. Alexander Schallenberg;
- Bisedë telefonike me homologun nga Republika e Maldiveve, Z. Abdulla Shahid;
- Bisedë telefonike me Ministrin e Punëve të Jashtme të Gjermanisë, Z. Heiko Maas;
- Bisedë telefonike me homologun e Kroacisë, Ministrin e Punëve të Jashtme dhe Çështjeve Evropiane, Z. Gordan Grlić Radman;
- Bisedë telefonike me homologun nga Letonia, Z. Edgars Rinkēvičs;
- Bisedë telefonike me Zv. Kryeministren për Reformë Juridike dhe Ministren e Jashtme të Republikës së Bullgarisë, Znj. Ekaterina Zaharieva.
- Bisedë telefonike me homologun nga Lituania, Z. Linas Linkevičius;
- Bisedë telefonike me homologun nga Jordania, Z. Ayman Al Safadi;
- Bisedë telefonike me homologun nga Franza, Z. Jean Yves Le Drian;
- Bisedë telefonike me homologun nga Britania Znj. Wendy Morton
- Bisedë telefonike me homologun nga Italia, Z. Luigi Di Maio
- Bisedë telefonike me Ministrin e shtetit për Diasporë në Shqipëri, Z. Pandeli Majko

1.3.Video Konferencat e zhvilluara me:

- Video konferencë me shëfat e misionëve diplomatike të Republikës së Kosovës në botë;
- Ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë Z. Philip Kosnett;
- Ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Z. Nicholas Abbott;
- Homologun austriak Z. Alexander Schallenberg;
- Ambasadori i Austrisë në Kosovë, Z. Christofer Weidinger;
- Homologun nga Malajzia, Z. Hishammuddin Tun Hussein;
- Ambasadorin e Austrisë në Kosovë, Z. Christofer Weidinger;
- Ambasadorin e Norvegjisë në Kosovë, Z. Jens Erik Grøndahl;
- Ambasadorin e Çekisë në Kosovë Z. Pavel Bilek;
- Ambasadorin e Kroacisë në vend, Znj. Danijela Barišić;
- Ambasadorin e Finlandës në Kosovë, Znj. Pia Stjernvall;
- Drejtoreshën e NDI në Kosovë, Znj. Nancy E.Soderberg.
- Ambasadorin e Suedisë në Kosovë, Znj. Karin Hernmarck Ahliny
- Homologu nga Kuvajti, Z. Ahmad Nasser al-Mohammad Al Sabah
-

1.4.Vizita në Bruksel

- Takim me kryesuesin e Komitetit për Punë të Jashtme të Parlamentit Evropian, Z. David McAllister;
- Takim me Zëvendës Sekretarit Gjeneral të NATO-s, Z. Mircea Geoana;
- Takim me Përfaqësuesen e Përhershme të Mbretërisë së Bashkuar në NATO, Z. Sarah MacIntosh;
- Takim me Sekretaren e Përgjithshme të Shërbimit të Jashtëm Evropian, Znj. Helga Schmid;
- Takim me Përfaqësuesen e Përhershme të ShBA-ve në Nato, Znj.Kay Bailey Hutchinson;
- Takim me përfaqësuesin e përhershëm të Italisë në NATO, Z. Francesco M. Talo;
- Takim me diasporën tonë në Bruksel.

1.5.Vizita në Mal të Zi

- Takim me Nënkryetarin e Parlamentit të Malit të Zi, Deputetin shqiptar, Z. Genc Nimanbegu dhe Kryetarin e “Forcës”, z.Nazif Cungu;
- Takim me Z. Faik Nika nga Këshilli Kombëtar i Shqiptarëve;
- Takim me Ministrin për të Drejtat e Njeriut dhe Pakicat, njëkohësisht Kryetarin e Unionit Demokratik Shqiptar, Z. Mehmet Zenka;
- Takim me Kryetarin e Lëvizjes Qytetare “Perspektiva”, Amir Hollaj;
- Takim me Kryetarin e Lidhjes Demokratike në Mal të Zi Z. Saubih Mehmeti, dhe Kryetarin e Partisë Demokratike, Z. Fatmir Gjeka;
- Takim me Kryetarin e Komunës së Tuzit, Z. Nik Gjeloshaj.

1.6.Vizita tjera

- Vizitë në një delegacion të përbashkët me Ministrin e Drejtësisë së Republikës së Kosovës, Z. Selim Selimi, në Luginën e Preshevës;
- Vizitë në Qendrën për Promovimin e të Drejtave të Grave në Drenas.

9. Procesi i aderimeve në Konventat Ndërkombëtare

Me datë 22.07.2020, Ministria për Punë të Jashtme dhe Diasporë (MPJD) depozitoi përmes Ambasadës së Republikës së Kosovës në Zvicër instrumentet e aderimit në konventat si në vijim:

- Konventa (I) për Zbutjen e Kushteve të Lënduarve dhe të Sëmurëve në Forcat e Armatosura në Tokë e dates 12.08.1949 (*Convention (I) for the Amelioration of the Condition of the Wounded and Sick in Armed Forces in the Field. Geneva, 12 August 1949*).
- Konventa (II) për Zbutjen e Kushteve të Lënduarve, të Sëmurëve dhe të Anijembyturve në Forcat e Armatosura në Det e dates 12.08.1949 (*Convention (II) for the Amelioration of the Condition of Wounded, Sick and Shipwrecked Members of Armed Forces at Sea. Geneva, 12 August 1949*).
- Konventa (III) për Trajtimin e Robërve të Luftës e dates 12.08.1949 (*Convention (III) relative to the Treatment of Prisoners of War. Geneva, 12 August 1949*).
- Konventa (IV) për Mbrojtjen e Personave Civil gjatë Luftës e dates 12.08.1949 (*Convention (IV) relative to the Protection of Civilian Persons in Time of War. Geneva, 12 August 1949*).
- Protokoli shtesë (Protokoli I) i Konventave të Gjenevës të dates 12.08.1949 në lidhje me mbrojtjen e viktimave të konflikteve ndërkombëtare të armatosura i dates 08.06.1977 (*Protocol Additional to the Geneva Conventions of 12 August 1949, and relating to the Protection of Victims of International Armed Conflicts (Protocol I), 8 June 1977*).
- Protokoli shtesë (Protokoli II) i Konventave të Gjenevës të dates 12.08.1949 në lidhje me mbrojtjen e viktimave të konflikteve jo-ndërkombëtare të armatosura i dates 08.06.1977 (*Protocol Additional to the Geneva Conventions of 12 August 1949, and relating to the Protection of Victims of Non-International Armed Conflicts (Protocol II), 8 June 1977*).
- Protokoli shtesë (Protokoli III) i Konventave të Gjenevës të dates 12.08.1949 në lidhje me miratimin e emblemës shtesë dalluese e datës 08.12.2005 (*Protocol additional to the Geneva Conventions of 12 August 1949, and relating to the Adoption of an Additional Distinctive Emblem (Protocol III), 8 December 2005*).

Konventat dhe protokolet në fjalë kodifikojnë të drejtën ndërkombëtare humanitare dhe paraqesin standardin ndërkombëtar në këtë fushë. Këto konventa dhe protokole janë të hapura për të gjitha shtetet që të aderojnë.

Me datë 22.07.2020, MPJD përmes Ambasadës së Republikës së Kosovës në ShBA po ashtu ka dërguar për depozitim instrumentet e aderimit në konventat si në vijim:

- Konventa ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike e datës 16.12.1966 (*International Covenant on Civil and Political Rights of 16 December 1966*).
- Protokoli opsional i konventës ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike i datës 16.12.1966 (*Optional Protocol to the International Covenant on Civil and Political Rights of 16 December 1966*).
- Protokoli opsional i dytë i konventës ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike i datës 15.12.1989 (*Second Optional Protocol to the International Covenant on Civil and Political Rights of 15 December 1989*).
- Konventa ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor e dates 21.12.1965 (*International Convention on the Elimination of All Forms of Racial Discrimination of 21 December 1965*).
- Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave e dates 18.12.1979 (*Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination against Women of 18 December 1979*).
- Protokoli opsional i konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave i dates 06.10.1999 (*Optional Protocol to the Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination against Women of 6 October 1999*).
- Konventa kundër tortures dhe trajtimeve dhe dënimeve mizore, jonjerëzore dhe degraduese e dates 10.12.1984 (*Convention against Torture and Other Cruel, Inhuman or Degrading Treatment or Punishment 10 December 1984*).
- Protokoli opsional i konventës kundër tortures dhe trajtimeve dhe dënimeve mizore, jonjerëzore dhe degraduese i dates 18.12.2002 (*Optional Protocol to the Convention against Torture and other Cruel, Inhuman or Degrading Treatment or Punishment of 18 December 2002*).
- Konventa për të drejtat e fëmijës e dates 20.11.1989 (*Convention on the Rights of the Child of 20 November 1989*).
- Protokoli opsional i konventës për të drejtat e fëmijës për përfshirjen e fëmijëve në konfliktet e armatosura i dates 25.05.2000 (*Optional Protocol to the Convention on the Rights of the Child on the involvement of children in armed conflict of 25 May 2000*).

- Protokoli opsional i konventës për të drejtat e fëmijës për shitjen e fëmijëve, prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë e fëmijëve i dates 25.05.2000 (*Optional Protocol to the Convention on the Rights of the Child on the sale of children, child prostitution and child pornography of 25 May 2000*).
- Protokoli opsional i konventës për të drejtat e fëmijës për procedurën e komunikimit i dates 19.12.2011 (*Optional Protocol to the Convention on the Rights of the Child on a communications procedure of 19 December 2011*).
- Konventa e Vjenës për Traktatet e dates 23.05.1969 (*Vienna Convention on the Law of Treaties of 23 May 1969*).
- Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike e dates 18.04.1961 (*Vienna Convention on Diplomatic Relations of 18 April 1961*).
- Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore e dates 24.04.1963 (*Vienna Convention on Consular Relations of 24 April 1963*).

Depozitar i këtyre konventave është Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Konventat janë të hapura për aderim për gjitha shtetet, përkatësisht për shtetet që janë anëtarë të një ose më shumë agjencive të specializuara të Kombeve të Bashkuara. Kosova është anëtare e dy agjencive të specializuara, që janë Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore. Anëtarësimi në Kombet e Bashkuara nuk është parakusht për aderim në këto konventa. Roli i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara është vetëm administrativ dhe nuk guxon të paragjykojë statusin politik të Kosovës apo të mos e trajtojë Kosovës si shtet.

Me aderimin në këto konventa Republika e Kosovës plotëson dhe ndërkombëtarizon standardin e të drejtave të njeriut pasi që pjesa dërrmuese e konventave në fjalë zbatohen si pjesë përbërëse e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Republika e Kosovës po ashtu do të përfaqësohet vet në mekanizmat ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.

Në rrafshin politik, aderimi i Kosovës në këto konventa e vendos Kosovën “me një këmbë” brenda sistemit të Kombeve të Bashkuara, sepse të gjitha mekanizmat e të drejtave të njeriut veprojnë nën ombrellën politike të Kombeve të Bashkuara. Kombet e Bashkuara e kanë vështirë të argumentojnë kundër aderimit të Kosovës në këto konventa sepse me këtë do të mohonin zbatimin e të drejtave të njeriut për popullin e Kosovës. Kjo do të cenonte parimin e universalitetit të drejtave të njeriut dhe do të kundërshtonte konceptin që të drejtat e njeriut i takojnë individëve e jo shteteve. Në anën tjetër, aderimi në këto konventa e ndërkombëtarizon Kosovën dhe e bën pjesëtare të barabartë shtetërore të mekanizmave

ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Kjo i hap rrugë Kosovës për aderime në konventa të tjera dhe lehtëson anëtarësimin në organizata ndërkombëtare.

Këto aderime nuk e cenojnë procesin e dialogut sepse përfitues i këtyre aderimeve janë të gjithë qytetarët e Kosovës, në veçanti komunitetet pakicë, të cilat do të mund të thirren në mekanizmat ndërkombëtar për të drejtat me njeriut.

PJESA E TRETË

I. PLANI I PUNËS SIPAS DEPARTAMENTËVE TË MPJD-së DHE SFIDAT

Në pjesën e tretë të këtij raporti janë të paraqitura çështjet sipas departamenteve të MPJD-së. Çështjet e paraqitura në këtë pjesë përfshijnë gjendjen ekzistuese, sfidat dhe rekomandimet për çdo temë që elaborohet në këtë pjesë të raportit.

1. ÇËSHTJET BILATERALE

1.1.Hyrje

Prioriteti i politikës së jashtme i Republikës së Kosovës në promovimin e sovranitetit të Republikës së Kosovës dhe njohjes ndërkombëtare mbetet prioritet i pandryshuar që nga viti 2008. Për më shumë, politika e jashtme angazhohet në ndërtimin dhe konsolidimin e marrëdhënieve të mirëfillta dypalëshe të bazuara në respekt të ndërsjellë për promovimin e interesave të përbashkëta ndërshtetërore. Synim kryesor i politikës sonë të jashtme në aspektin dypalësh mbetet:

- Lobimi për njohje të reja (për vendet mosnjohëse) dhe thellimi i marrëdhënieve me vendet njohëse.

Fuqizimi i marrëdhënieve dypalëshe ka theks të veçantë në bashkëpunim politik, diplomatik, ekonomik, arsimor, kulturor. Kjo bëhet me qëllim të identifikimit të fushave të interesit të ndërsjellë dhe ndërtimit të marrëdhënieve të mirëfillta me shtetet e tjera. Marrëdhëniet e formalizuara, përfshirë ato politike, ekonomike dhe kulturore i referohen ekskluzivisht linjave të veprimit bilateral apo multilateral ndërmjet dy apo më shume shteteve, në instanca bilaterale apo edhe në kuadër të organizatave të ndryshme ndërkombëtare. Partneritetet ndërmjet shteteve zakonisht jetësohen përmes nënshkrimit të

marrëveshjeve, inicimit të nismave, hapjes së misioneve diplomatike, themelimit të instituteve të përbashkëta.

1.2.Çështjet bilaterale – gjendja aktuale

Republika e Kosovës momentalisht njihet nga 116 shtete (anëtare dhe jo anëtare të OKB-së) ndërsa gjeografia e njohjeve është gjithëpërfshirëse. Sa i përket aspektit të njohjes ndërkombëtare, statistikat tregojnë që kemi potencial të mirë të zhvillimit të marrëdhënieve bilaterale me pothuajse të gjitha kontinentet në nivel shumë të kënaqshëm. Prioritet i lartë mbetet ruajtja dhe kultivimi i raporteve me ShBA-të dhe MPJD i kushton vëmendje të posaçme thellimit të mëtejme të bashkëpunimit me ShBA, përmes angazhimit konkret të Ambasadës së RKS në Uashington dhe adresimit të temave dhe çështjeve në koordinim MPJD - Ambasadë e ShBA-ve në Prishtinë.

Republika e Kosovës deri më sot ka të vendosura marrëdhënie diplomatike me 88 shtete. Me shtete të caktuara dhe shtete njohëse me tendenca fragjile të mbajtjes së njohjeve/raporteve MPJD-së gjatë vitit 2020, në koordinim të ngushtë me aleatë ka reaguar me urgjencë dhe me efikasitet.

Këtë vit është hapur Ambasada e Japonisë në Kosovë, një lajm shumë i mirë për Kosovën. MPJD trajton me kujdes të veçantë raportet me Japoninë dhe kultivon raporte profesionale me diplomatë japonez të akredituar në këtë ambasadë.

Vitin e kaluar janë mbajtur konsulta politike në nivel të Drejtorive të Përgjithshme me MPJ të Kanadasë dhe Australisë në Prishtinë. Ndërsa në kuadër të fushatës për lobim për Interpol janë organizuar konsulta politike me autoritete të larta në Panama, Australi, disa shtete të Oqeanisë, Senegal, në Turqi me misionet diplomatike të Jordanisë, Afganistanit dhe Pakistanit, dhe me misioni diplomatik të Malajzisë në Itali.

a) Hapja e ambasadave të reja

Gjatë vitit 2019 janë hapur katër ambasadat e reja të Republikës së Kosovës: në Emiratet e Bashkuara Arabe, Bangladesh, Katar dhe Tajlandë. Kjo shënon një sukses të prekshëm në shtrirjen dhe fuqizimin e rrjetit diplomatik të Republikës së Kosovës me qëllim avancimin e pozicionit ndërkombëtar të Kosovës. Të katër misionet janë funksionale dhe operative me ambasadorë dhe diplomatë të akredituar dhe me akreditim sekondar në shtetet përreth. Në ndërkohë, presim përgjigje nga shtetet respektive për hapje të misioneve të reja të RKS në Kolumbi, Tanzani dhe Kuvajt. Gjatë vitit 2019 kanë filluar punën dy ambasadorë të ri në misionet në Kanbera dhe Riad, ambasadori Hajdin Abazi (Kanbera) dhe Lulzim Mjeku (Riad). Ambasadori i RKS në Otava Lulzim Hiseni ka lëvizur në MPJD, ndërsa Adriatik Kryeziu (së fundi diplomat në ARKS në Pragë) ka filluar punën si Ambasador në Otavë. Ambasadorja e RKS në Panama Zana Rudi pas përfundimit të mandatit ka lënë shërbimin

e jashtëm ndërsa Ambasadore në Panama është dekretuar Heroina Telaku (së fundi diplomate në ARKS në Londër).

b) Marrëveshjet bilaterale

Deri më sot Republika e Kosovës i ka të nënshkruara rreth 380 marrëveshje ndërshtetërore (me të gjitha shtetet) dhe 28 marrëveshje me BE-në. Në këtë shifër nuk hynë marrëveshjet ndërinstucionale e as nismat që janë në procedim e sipër të cilat mund të shkojnë tek numri 50. Sfidë mbetet nënshkrimi i marrëveshjeve për vendosje të marrëdhënieve bilaterale me vendet njohëse të Afrikës dhe Azisë. Kjo do t'i paraprinte inicimit të marrëveshjeve bilaterale me këto vende si hap i parë i krijimit të një qëndrueshmërie raportesh në funksion edhe të eliminimit të rrezikut për çnjohje (praktikë tanimë e vënë në zbatim).

Sa i përket rajoneve dhe shteteve jashtë Evropës, MPJD në periudhën 2019-2020 ka nënshkruar dhe iniciuar këto marrëveshje:

- Është nënshkruar marrëveshja për eliminimin e tatimit të dyfishtë me Arabisë Saudite;
- Janë nënshkruar MoU për konsulta politike dhe MoU për bashkëpunim ndërmjet Akademive Diplomatike me Hondurasin;
- Janë propozuar për inicim një sërë marrëveshjesh kornizë ndërqeveritare dhe ndërinstucionale me Bangladeshin, Tajlandën, Senegalin, Katarin, Emiratet e Bashkuara Arabe, Jordaninë dhe Irakun;
- Ka filluar komunikimi me MPJ të Australisë, Zelandës së Re dhe misionet e Saint Kitts & Nevis, Belizesë dhe Barbadosit në Bruksel për inicimin e tri marrëveshjeve: *Marrëveshjes për heqjen e vizave për bartësit e pasaportave diplomatike, MoU për konsulta politike, MoU për bashkëpunim ndërmjet Akademisë Diplomatike të RKS me Akademi/Institute Diplomatike të këtyre vendeve.*

Vitin 2019, përmes Ambasadorit të RKS në Tajlandë, jo-resident për Maldive janë iniciuar këto marrëveshje:

- MoU për konsulta politike ndërmjet MPJ-ve;
- Marrëveshje për heqje të tatimit të dyfishtë;
- Marrëveshje për mbrojtje të investimeve;
- MoU për Akademi Diplomatike.

1.3.Sfidat në rrafshin bilateral

Sfida kryesore mbetet përhapja e pandemisë COVID-19 e cila ka penguar realizimin e planit dinamik të MPJD-së në rrafshin bilateral për vitin 2020.

Sfida tjera mbesin edhe:

- Jo-stabiliteti politik viteve të fundit në Republikën e Kosovës e që pengon vazhdimësinë e veprimit;
- Pozicioni agresiv diplomatik i Serbisë vis-à-vis shteteve të cilat nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës, dhe shteteve njohëse me pozicion labil sa i përket qëndrimeve konsekuente në raport me politikën e tyre të jashtme;
- Mos-kultivimi i raporteve me shtetet njohëse, e sidomos me shtetet njohëse me pozicion labil sa i përket qëndrimeve konsekuente në raport me politikën e e tyre të jashtme;
- Mos-vendosja e marrëdhënieve diplomatike me shtetet njohëse, rrjedhimisht pamundësia e ndërtimit të partneritetit të cilin do ta shfrytëzoni edhe për çështje të lobimit. Ky mbetet objektiv strategjik i MPJD-së duke qenë se konfirmon seriozitetin dhe vendosmërinë për të hyrë në raporte kontraktuale me interes të dyanshëm me ato vende.

1.4.Plani i veprimit

Në kuadër të MPJD-së, me vendim të Ministres Haradinaj-Stublla është ngritur komisioni i brendshëm i cili do të analizojë raportet bilaterale të Republikës së Kosovës, dhe i cili do të dalë me rekomandime konkrete.

Po ashtu, në periudhën afatshkurtër Ministrja Haradinaj Stublla do të organizojë takime virtuale me të gjithë Ministrat e vendeve ku kemi misione diplomatike dhe në vende të cilat i mbulojmë me akreditim sekondar.

Ndërtimi i marrëdhënieve me shtetet njohëse do të bëhet në dy drejtime respektive varësisht nga shteti në fjalë, shtetet njohëse me të cilat kemi marrëdhënie diplomatike dhe shtetet njohëse me të cilat nuk kemi marrëdhënie diplomatike. Me pjesën e dytë të shteteve është propozuar lidhja/vendosja e marrëdhënieve diplomatike me ç ‘rast do të kemi prani më të madhe në rajone tjera gjeografike përveç Evropës. Krahas kësaj, paralelisht në të dy grupet e shteteve (me të cilat kemi marrëdhënie diplomatike dhe me të cilat nuk kemi marrëdhënie diplomatike) janë duke u propozuar nënshkrime të marrëveshjeve me interesa të përbashkëta reciproke.

Objektivat kryesore afatshkurtër dhe afatmesme në vendosjen dhe thellimin e marrëdhënieve bilaterale do të jenë:

- Vendosja e marrëdhënieve diplomatike (*edhe në funksion të lobimit dhe përkrahjes për anëtarësim në mekanizma multilateral*);
- Partneriteti me shtetet me ndikim;
- Inicimi i marrëveshjeve bilaterale me interes dypalësh;

- Fuqizimi i imazhit të MPJD-së;

Përmes këtyre objektivave synohet:

- Thellimi i marrëdhënieve dhe bashkëpunimit;
- Vendosja e marrëdhënieve diplomatike me ato vende që nuk kemi;
- Fasilitimi i lobimit dhe ndryshimi i qëndrimit të vendeve jo-njohëse.

Treguesit e matjes janë:

- Fuqizimi i misioneve diplomatike në Panama, Bangladesh, Tajlandë, Senegal, Australi;
- Autorizimi me vendim për diplomatë të RKS në Nju Jork, Vjenë, Gjenevë, Paris, Londër, Berlin, Romë, Bruksel që të trajtonë me prioritet të lartë çështjet e marrëdhënieve me vendet e Amerikës Jugore, Afrikës, Azisë dhe Paqësorit. Ku ka nevojë të shtohet numri i diplomatëve në këto misione;
- Mbulimi i gjeografive dhe çështjeve që kanë të bëjnë me këto gjeografi përmes Ambassador-at-large;
- Numri i misioneve të reja diplomatike të hapura në vendet më strategjike me interes për forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës (Poloni, Kolumbi, Egjipt, Tanzani, Malajzi, Singapor);
- Rritja e numrit të shteteve që mbulohen me mbulim jo-rezident;
- Rritja e numrit të marrëveshjeve të iniciuara dhe të nënshkruara me vendet përkatëse (*formimi i një mekanizmi fasilitues ndërqeveritar për të përshpejtuar procesin e negociimit dhe miratimit të këtyre marrëveshjeve nga pala kosovare*).

2. NATO

2.1.Gjendja e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe NATO-s

Republika e Kosovës (RKS) është e vendosur për t'u bërë një partner proaktiv për paqen, sigurinë dhe prosperitetin. Andaj të qenit pjesë e NATO-së si një aleance që promovon dhe mbron vlerat e përbashkëta si paqja, siguria dhe demokracia vazhdon të jetë një nga prioritetet kryesore kombëtare. Bashkëpunimi i RKS me NATO-n realizohet në 3 shtylla: Ndërveprimi i Shtuar (Enhanced Interaction), KFOR-i dhe NALT (NATO Advisory Liaison Team) dhe angazhimi aktual i NATO-së ndaj institucioneve të RKS përfshin mbështetjen e FSK dhe Ministrisë së Mbrojtjes (MM), përderisa përmes KFOR-it, NATO-ja vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e paqes dhe të sigurisë.

Trupat e KFOR-it konsistojnë aktualisht në 3532 pjesëtarë (19 NATO dhe 8 Partnere), përderisa NALT ka rol të rëndësishëm në këshillimin e institucioneve të sigurisë në Kosovë dhe në implementimin e programeve në kuadër të bashkëpunimit RKS – NATO.

Tranzicioni i FSK-së është duke u bërë në bashkëpunim të ngushtë me aleatë strategjike anëtar të NATO-s, në mënyrë që RKS ta ketë një forcë profesionale dhe gjithë përfshirëse, e cila do të rrisë sigurinë dhe stabilitetin rajonal, do të kontribuojë në integrimin euro-atlantik të Kosovës dhe do t'i mundësojë Kosovës të bëhet një ofrues (*provider*) aktiv në kuadrin e sigurisë rajonale dhe globale. Marrë në konsideratë rëndësinë e pjesëmarrjes së FSK në Operacionet e Mbështetjes së Paqes me NATO-n dhe organizatave tjera ndërkombëtare, MPJD në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes, ka iniciuar procedurën edhe për tre vende tjera, me qëllim të pjesëmarrjes së FSK në misione jashtë vendit (si në Afganistan, Kuvajt dhe Irak).

2.2.Sfidat në marrëdhëniet RKS-NATO

Me gjithë përkrahjen aktuale që ka Kosova në NATO, ku 25 nga 29 shtetet janë mbështetëse të Kosovës në rrugën e afrimit dhe anëtarësimit të saj në NATO, problemi kyç është mosnjohja e Kosovës nga 4 shtete anëtare (Spanja, Rumania, Sllovakia dhe Greqia). Këtë e vështirëson edhe mënyra e funksionimit të NATO-s, gjegjësisht domosdoshmëria e arritjes së konsensusit të plotë për secilën çështje.

Si rrjedhojë e këtyre dy elementeve më lart, ka pengesë për avancimin e marrëdhënieve në dy pika konkrete:

- Përfshirjes në Partneritet për Paqe (PfP), e cila në aspektin politik do të përbënte fillimin e një kapitulli të ri bashkëpunimi me NATO drejt integritit të plotë në strukturën Euro-Atlantike;
- Vendosi dhe zhvillimit të dialogut politik në nivelin më të lartë institucional me NATO-n.

2.3.Rekomandimet

- Fuqizimi i pranisë së RKS në Bruksel, përmes funksionalizimit sa më të shpejtë të ekipit të Misionit të ardhshëm të Republikës së Kosovës në NATO, duke përfshirë të Deleguarin e Qeverisë për bashkërendim të marrëdhënieve RKS-NATO dhe stafin përcjellës dhe mbështetës diplomatik dhe ushtarak;
- Në bashkëpunim me MM dhe Misionet diplomatike të RKS në Bruksel dhe shtetet e Kuintit, organizimin e vizitave të kombinuara në selinë e NATO-s si dhe në kryeqendrat e Kuintit;

- Përforcimin e bashkëpunimit dypalësh me vendet anëtare të NATO-s në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, përmes rritjes së marrëveshjeve bilaterale dhe akreditimit të atasheve të mbrojtjes në shtetet anëtare të NATO-s;
- Forcimi i shkëmbimeve bilaterale me shtete anëtare jo-njohëse me qëllim të ndryshimit të qëndrimit në favor të përkrahjes së Kosovës drejt anëtarësimit në NATO;
- Përforcimi i bashkëpunimit RKS-NATO në kuadër të Ndërveprimit të Shtuar (Enhanced Interaction) përmes realizimit të vizitave më të shpeshta të NATO-s në Kosovë, përforcimit të bashkëpunimit praktik dhe politik RKS-NATO si dhe intensifikimit të pjesëmarrjes së FSK në aktivitetet, programe të NATO-s, trajnime dhe stërvitje;
- Të intensifikohet diplomacia parlamentare me vendet anëtare - si në mënyrë bilaterale ashtu edhe brenda Asamblesë Parlamentare të NATO.

3. EUROPOLI DHE INTERPOLI

3.1.Europoli

Procesi i arritjes së marrëveshjes në mes të Kosovës dhe EUROPOL-it, ishte proces i gjatë i zhvilluar nga viti 2016.

Formalisht procesi për arritjen e një marrëveshje të bashkëpunimit ka filluar më 16 Nëntor 2016 kur është shkruar letra e parë nga Ministri i Punëve të Brendshme për Drejtorin e EUROPOL-it. Në këtë letër shprehet gatishmëria e Kosovës për rritjen e bashkëpunimit me EUROPOL-in dhe për interesin e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit.

Më 12 Dhjetor është pranuar përgjigjja me shkrim nga Drejtori i EUROPOL-it, në të cilën thuhet se bashkëpunimi duhet të shqyrtohet për një kohe tjetër pas miratimit të rregullores së re të EUROPOL-it.

Me përkrahjen e Bashkimit Evropian është caktuar një takim në Bruksel me datë 05 Prill 2017 me qëllim të hulumtimit të modaliteteve të avancimit të Bashkëpunimit të Kosovës me EUROPOL dhe EUROJUST.

Më datë 13 Dhjetor 2017 në takimin e Bordit Menaxhues të EUROPOL-it më e mbajtur Kosova futet në listën e partnereve të kësaj Organizate e cila listë mandej mundëson fillimin e formalizimit të marrëdhënieve të bashkëpunimit përmes marrëveshjes së Punës. 17 janar 2019, Pranojmë draftin e parë të Draft marrëveshjes. Ky draft mandej është diskutuar nga grupi punues dhe janë shkëmbyer diskutime përmes postes elektronike dhe

bisedave telefonike. Më datë 06 Mars 2019 Ministri i Punëve të Jashtme njofton me shkrim Ministrin e Punëve të Brendshme për përfshirjen e nismës në për marrëveshjes për miratim në parim.

Më 15 mars 2019 Ministri i MPJ-së jep pëlqimin për përbërjen e delegacionit teknik për shqyrtim dhe negociim (ekipit negociator). Ekipi Negociator është përbërë nga: Kolonel Riza Shillova Drejtor i Departamentit të Hetimeve , Kryesues, Major Veton Elshani (i zëvendësuar më vonë nga major Besnik Sallahu) Drejtoria për Bashkëpunim Ndërkombëtarë në Fushën e Zbatimit të Ligjit- ILECU, z. Dardan Koçani, Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave MPB, nga znj. Albesjana Iberhysaj) Divizioni për Traktate dhe Marrëveshje Ndërkombëtare, MPJ dhe z. Arben Kqira, Departamenti Ligjor MPB.

Me datën 10 dhe 11 shkurt 2020 është organizuar një takim i përbashkët për negociim të marrëveshjes mes dy ekipeve ne Selinë e EUROPOL-it në Hagë. Nga Pala Kosovare kanë qen prezent në takim Kolonel Riza Shillova udhëheqës i ekipit, z. Dardan Kocani Drejtor për Integrim Evropian MPB dhe Major Besnik Sallahu Drejtori i ILECU-t. Nga pala e EUROPOL-it është përfaqësuar me z. Bart De Buck – Udhëheqës i Ekipit BE & Ligji Ndërkombëtarë dhe znj. Teodora Todorova – BE & Ligji Ndërkombëtare.

Si Më datë 16.07.2020 kemi marrë konfirmimin se marrëveshja është nënshkruar nga Drejtoresha e EUROPOL-it dhe se e njëjta është përcjell përmes Ambasadës tonë në Hagë për procedim të mëtejshëm për nënshkrim nga Ministri i Punëve të Brendshme z. Agim Veliu. Vendimi për nënshkrim të marrëveshjes përmes shkëmbimit të dokumentacionit është marrë pasur parasysh pamundësinë e takimit dhe organizimit të ceremonisë së nënshkrimit për shkak të pandemisë.

Me datën 16.07.2020 janë dërguar edhe komentet në dy draft marrëveshjet tjera: për Zyrтарin ndërlidhës dhe për kanalën e sigurt të komunikimit . Këto dy marrëveshje nuk kanë nevojë të kalojnë ne Bordin Ekzekutiv te EUROPOL-it për miratim. Këto dy marrëveshje gjithashtu do të nënshkruhen për një kohë të shkurtër.

Me 27.07.2020 është dhënë pëlqimi nga Ministrja Meliza Haradinaj Stublla, Ministrit të Punëve të Brendshme, për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me EUROPOLIN.

3.2. Interpoli

Më 26 shkurt 2020, ZvDP Zemaj dhe Rexhep Bajraktari (nga Konsullata e Përgjithshme në Gjenevë) janë takuar më zyrën ligjore të Interpol-it, në seli të organizatës në Lyon, për të dorëzuar letrën e Ministrit Konjuca lidhur me vendimin për të mos aplikuar për anëtarësim në këtë organizatë në AP të radhës e cila mbahet në tetor 2020 në Uruguai, dhe

me kërkesë që të trajtohet dosja e RKS-së në AP të vitit 2021 e cila do të mbahet në Stamboll.

Delegacioni i RKS është pritur nga:

- Znj. Mary Rodriguez (shtetase amerikane), Këshilltare e Përgjithshme dhe Drejtore e çështjeve ligjore në INTERPOL;
- Znj. Joyce Eaton (shtetase libaneze), juriste në zyrën ligjore, dhe përgjegjëse për dosjen e RKS-së.

Pas një përshkrimi të rikonfigurimit politik në RKS, pas informimit rreth përvojës së pjesëmarrjes së RKS-së në AP në Kili, përfaqësuesi i MPJD-së përshkroi sfidat me të cilat është ballafaquar delegacioni i RKS-së si dhe gjithë procesin deri në mbajtjes e Asamblesë. Duke përshkruar rrethanat në të cilat gjendet RKS (dialogu me Serbi) dhe konfigurimi i mbajtjes së seancës të radhës, në një shtet jo njohës, përfaqësuesi i MPJD-së njoftoi përfaqësuesit të INTERPOL-it rreth vendimit të Ministrit për të mos aplikuar për vitin 2020, duke dorëzuar letrën e Ministrit drejtuar Sekretariatit të Përgjithshëm dhe Komitetit Ekzekutiv.

Znj. Rodriguez, duke mirëpritur vendimin në fjalë, theksoi që do t'i njoftojë anëtarët e KE si dhe shtetet anëtare. Ajo insistoi në faktin që është një vendim shumë i qëlluar pasi që në rrethana aktuale shumë shtete presin të shohin evoluimin e dialogut në mes të Serbisë dhe RKS-së. Po ashtu ajo rikujtoi që SP i organizatës u ballafaqua me situatat të paparë në INTERPOL, të cilat e kanë vendosur organizatën si dhe RKS-në në pozitë të keqe, sikurse në Dubai, ku ishte hera e parë për organizatën që një shtet, i cili ishte futur në agjendë nga KE, iu refuzohet anëtarësimi nga AP. Kjo situatë ishte krejtësisht e panjohur për organizatën.

Ajo shfrytëzoi rastin për të rekomanduar që RKS të vendosë për aplikim të anëtarësimit vetëm kur është sigurt që ka siguruar mbështetje të mjaftueshme nga shtetet anëtare, do të thotë vetëm kur anëtarësimi është i sigurt. Një dështim i dytë do të ishte shumë i rëndë për RKS, sikurse për INTERPOL-in, duke pasur parasysh parimet e organizatës në të cilën asnjë polici e botës nuk duhet të lihet jashtë. Por në fund të fundit, nuk vendos organizata për anëtarësim por shtetet veç e veç.

Znj. Rodriguez ritheksoi që RKS nuk duhet të ngutet, dhe edhe nëse në kohën e mbajtjes së AP në Stamboll ka dyshime për anëtarësim, të pritët edhe pak.

Përfaqësuesi i MPJD-së, duke falënderuar bashkëbiseduesit, informoi rreth përforcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar të Policisë së RKS-së, duke përmendur marrëveshjen e ardhshme në pritje me EUROPOL. Po ashtu, ai kërkoi të shihen mundësitë e pjesëmarrjes së RKS-së si shtet vëzhgues në AP në Uruguai, gjë për të cilën do të informohemi gjatë javëve në vijim.

4. STRATEGJIA PËR SHTETET MOS NJOHËSE

4.1.Hyrje

Prioritet i politikës së jashtme i Republikës së Kosovës mbetet edhe lobimi për njohje të reja. Sot, Republika e Kosovës njihet nga 116 shtete ndërsa objektivi për të arritur 2/3 e njohjeve nga shtetet anëtare të OKB-së mbetet një objektivi ende i paplotësuar. Ndër arsyt kryesore për ngecjen në rritjen e numrit të njohjeve:

- Trajektorja e ndryshimeve të shpeshta qeverisëse vitet e fundit në Republikën e Kosovës, rrjedhimisht zhvendosja e fokusit dhe resurseve (financiare dhe humane) nga procesi i lobimit;
- Mungesa e buxhetit në shtimin e aktiviteteve lobuese dhe mosaktivizimi i resurseve njerëzore brenda institucioneve të Republikës së Kosovës, në veçanti të MPJD-së;
- Pozicioni agresiv diplomatik i Serbisë vis-à-vis shteteve të cilat nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës, dhe shteteve njohëse me pozicion labil sa i përket qëndrimeve konsekuente në raport me politikën e tyre të jashtme.

4.2.Gjendja aktuale

Procesi i lobimit për njohje të reja viteve të fundit është karakterizuar si proces shumë kompleks me përfshirje të akterëve të ndryshëm legjitim dhe jolegitim, pa koordinim ndërinstytucional, me intervenime sporadike dhe pa fokus e përqendrim të vazhdueshëm. MPJD në periudhën e fundit ka ndërmarrë veprime proaktive në raport me disa shtete në Amerikë Latine, Afrikë Perëndimore dhe Azi Juglindore. Veprimet janë institucionale dhe përmes kontakteve legjitime. Vendet jo njohëse janë targetuar në mënyrë të veçantë dhe me argumente specifike të pasqyrimin të vendit tonë për njohje të Kosovës. Në kuadër të MPJD, me vendim të Ministres është themeluar komisioni për analizë të marrëdhënieve bilatarele i cili do të shërbejë si dokument referues në nxjerrjen e argumenteve pozitive të cilat do të shërbejnë për të argumentuar nevojën për njohje të Republikës së Kosovës nga vendet jo-njohëse.

Në kuadër të ambasadave të Kuintit në Prishtinë ekziston një grup joformal që merret me çështje të njohjeve/ç'njohjeve dhe me të cilin MPJD është në kontakt të vazhdueshëm. Ka vazhduar bashkëpunimi i shkëlqyeshëm ndërmjet Ambasadës së SHBA-ve dhe MPJD-së në çështje të njohjeve/ç'njohjeve.

Për të argumentuar nevojën e njohjes si ndërtim i raporteve kontraktuale me interes të ndërsjellë, janë identifikuar:

- 31 marrëveshje bilaterale ndër-shtetërore dhe ndër-institucionale të cilat mund të nënshkruhen;
- 15 forma të iniciativave të natyrës teknike-financiare (me participim të institucioneve të RKS, donatorëve dhe partnerëve të tjerë);
- 3 forma të iniciativave në funksion të përfaqësimit (emërimi i konsujve të nderit, hapja e odave ekonomike dhe emërimi i këshilltarëve ekonomik).

Po ashtu, është përgatitur dokumenti argumentues për nevojën e krijimit të bursës për studentë nga vende mos njohëse dhe vende me qëndrim fragjil sa i përket njohjes së RKS.

4.3.Sfidat

Në temën e lobimit sfida kryesore mbetet përhapja e pandemisë COVID-19 dhe pamundësia e realizimit të planit dinamik të veprimit. Sfida tjera janë zhvendosja e fokusit të aleatëve në tema të brendshme, pozicionimi agresiv i Serbisë dhe i aleatëve të saj Rusisë dhe Kinës në vendet jo-njohëse, sidomos në Afrikë.

4.4.Plani i veprimit

- Themelimi i ekipit brenda MPJD-së për konsolidimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës qëllimi i të cilit do të jetë hartimi i analizave për lobim dhe konsolidim të raporteve bilaterale;
- Hartimi i strategjisë së re të lobimit;
- Qasja direkte ndaj vendeve që janë afër njohjes së pavarësisë së Kosovës (do të identifikohen shtetet);
- Organizimi i vizitave të Ministres së MPJD-së dhe delegacioneve të nivelit të lartë nga MPJD në vendet mosnjohëse [në varësi të COVID-19];
- Koordinimi i aktiviteteve për lobim me Ambasadat e Kosovës dhe ato të vendeve mike;
- Kërkimi i mbështetjes nga shtetet mike të Kosovës që kanë ndikim te këto vende;
- Organizim i takimeve të Ministres të MPJD-së me homologët e tij të vendeve njohëse dhe mosnjohëse në kuadër të takimeve multilaterale [në varësi të COVID-19];
- Ftesë për medie dhe përfaqësues të shoqërisë civile të vendeve jonjohëse që ta vizitojnë Kosovën;
- Ftesë për studentë të vendeve mosnjohëse, ofrimi i bursave për studime në Kosovë;

5. BASHKIMI EVROPIAN DHE RAJONI

5.1.Pasqyre e gjendjes së Departamentit për BE dhe Evropë

Departamenti për BE dhe Evropë, përpos që mbulon pjesën e Dialogut Politik me BE-në dhe përcjell agjendën e BE-së në këtë fushë në koordinim të ngushtë me MIE dhe institucionet relevante, mbulon po ashtu edhe marrëdhëniet dy paleshe kryesisht me shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet tjera të Evropës sipas nevojës dhe në bazë të kapaciteteve të resurseve humane brenda departamentit.

DEBE vazhdon të jetë përgjegjëse për agjendën e BE-se e cila përfshinë edhe raportimet rreth MSA-se, raportin e progresit (*country report*) dhe përgatitjen e KSA-se dhe qëndrimin shtetëror; Po ashtu vazhdon të përcjelle Mbretërinë e Bashkuar edhe shtetet mos njohëse: Greqinë, Qipron, Spanjën dhe Rumaninë. Prioritet i DEBE është agjenda evropiane. Zyrtaret e larte te DEBE gjithashtu janë përgjegjës për komunikim me ambasadat e RKS ne Evrope si dhe ambasadat e huaja ne RKS.

5.2.Marrëveshja e Stabilizim Asociimi – MSA - Dialogu Politik

Ministria e Punëve të Jashtme / DEBE është e përkushtuar në zbatimin me sukses të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim – MSA.

Titulli II i MSA-së e rregullon dialogun politik mes Kosovës dhe BE-së dhe konsiderohet dimension i rëndësishëm i kësaj marrëveshjeje. Pësha që ky titull mund të reflektoj e bënë njëkohësisht edhe shumë vështirë të realizueshëm në rrethanat aktuale. Për shkak të mos njohjes nga pesë shtetet anëtare të BE-së, MSA-ja e Kosovës përmban nenin ku përmendet se asnjë pjesë e MSA-së nuk duhet të nënkuptohet si njohje e Kosovës nga institucionet dhe vendet anëtare e BE-së, pra është një realitet i cili nuk ka mundur të anashkalohej as gjatë negociimit dhe është koncesionuar nga pala Kosovare për hir të së ardhmes evropiane.

Pengesat në rrugëtimin e Kosovës drejt integritimit evropian do të vazhdojnë të na përcjellin në këto rrethana prandaj hapësira për të përfituar në rrafshin ndërkombëtar brenda kontekstit të kësaj Marrëveshje është e kufizuar. Megjithatë ne po përpiqemi të punojmë dhe të përfitojmë sa më shumë me këtë që kemi në dispozicion.

Segmenti i Politikës së Jashtme, Mbrojtjes dhe Sigurisë, pra Dialogut Politik me BE-në, në rrethana normale do të nënkuptonte forcimin e lidhjeve të ndërsjella midis BE-së dhe Kosovës në gjashtë fushat në vijim:

- a) Harmonizimin e politikave të jashtme, sigurisë dhe të mbrojtjes;
- b) Pjesëmarrjen në komunitetin ndërkombëtare demokratike;
- c) Bashkëpunimi Rajonal dhe marrëdhëniet e mira ndër-fqinjësore;
- d) Normalizimin e qëndrueshëm dhe të dukshëm të marrëdhënieve me Serbinë;
- e) Bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë;
- f) Harmonizimin e politikave për sanksionet ndërkombëtare dhe masat restriktive;

Ndër elementet kryesore të dialogut politik dhe afrimit me politikën e BE-së nënkuptohet përafrimi me deklaratat dhe qëndrimet e përbashkëta të Këshillit të BE-së në lidhje me situatat apo zhvillimet politike dhe në lidhje me situatat e të drejtave të njeriut dhe abuzimet në vendet e treta. Përderisa pala tjetër kontraktuese, Bashkimi Evropian nuk ka treguar interesim të duhur në zbatimin e kësaj pjese, mund të fitohet përshtypja që Kosova ka ngecur mbrapa në shfrytëzimin e dialogut politik me BE-në. Përkundër kësaj ne deri më tani në vazhdimësi kemi dëshmuar se jemi duke e përafuar politikën tonë të jashtme me atë të BE-së, dhe këtë e kemi bërë përmes deklaratave publike duke e promovuar konvergjencën me disa nga masat e përbashkëta të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë.

Kemi hartuar një plan veprimi, të cilin në dhjetor 2018 i cili plan përfshin të gjashtë fushat e lartpërmendura, me objektiva afatshkurta dhe afatmesme, me qëllim të zbatimit sa më të suksesshëm të tyre në kuadër të Dialogut Politik.

1. Së pari, në kuadër të fushës së harmonizimit të politikave të jashtme, të sigurisë dhe mbrojtjes, ky Plan Veprimi ka për qëllim avancimin e bashkërendimit dhe koordinimit ndërinstitucional sa i përket përafrimit të politikës së jashtme, të sigurisë dhe mbrojtjes të Kosovës me atë të BE-së.

Në ndërkohë që ne duhet ta rrisim dialogun politik me vendet candidate si dhe vendet tjera me të cilat BE ka raporte diplomatike. Brenda konsultimeve politike që duhet t'i zhvillojmë me vendet e rajonit duhet filluar në mënyrë bilaterale të këmbëjmë përvojat e tyre në rrafshin e bashkë dyzimit të politikave të jashtme.

2. Fushë tjetër me rëndësi e dialogut politikë është pjesëmarrja e Kosovës në bashkësinë ndërkombëtare demokratike, (aty ku rrethanat e lejojnë sipas dispozitës së MSA-së), në skenarët kur BE ka konsensus të brendshëm. Kjo do ishte një hapësirë që do të mund të ndihmonte Kosovën në agjendën multilaterale sikur të mund të shtyhej nga shumica e shteteve anëtare.

3. Së treti, si fushë që mbulohet nga dialogu politik është bashkëpunimi rajonal dhe fqinjësia e mirë. Kosova do të vazhdojë të luajë rolë konstruktiv në rajon duke u siguruar që mbështetja e BE-së të reflektohet në konsolidimin e pjesëmarrjes së Kosovës në organizatat rajonale, pa komplikuar dhe vështirësuar pjesëmarrjen.

4. Së katërti, fusha që mbulohet në kuadër të Dialogut Politik është normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë. Perspektiva evropiane e Kosovës dhe përafrimi me BE-në në

përputhje me perspektivën evropiane të rajonit, kushtëzohet me përmirësimin e dukshëm dhe të qëndrueshëm të marrëdhënieve me Serbinë pra normalizimin e marrëdhënieve KS-SR. Ky segment i përmbush dispozitat e bashkëpunimit rajonal, si dhe zgjidhjen e çështjeve të hapura, që zakonisht aspirohet në zgjidhjet paqësore të konflikteve mes shteteve që aspirojnë anëtarësimin në BE.

5. Së pesti, fusha që mbulohet nga dialogu politik me BE-në është bashkëpunimi në drejtësi, liri dhe siguri pra promovimi i kontributit të Kosovës në çështjet e ndërlidhura me drejtësinë, lirinë dhe sigurinë.

6. Së fundmi në kuadër të dialogut politik me BE-në është bashkëpunimi i Kosovës sa i përket sanksioneve të BE-së ndaj vendeve tjera. Ne gjerë tani jemi dëshmuar si partner kredibil dhe kemi dëshmuar publikisht që përcjellim qëndrimet e BE-së, përderisa jemi duke i finalizuar përgatitjet e nevojshme ligjore për të qenë sa më të përgatitur. Si dhe posa të miratohet edhe ligji për Sanksionet e shënjestruara, ne do të fillojmë me përgatitjen e mekanizmave ndërinstitucional të cilët do të na mundësojnë edhe zbatimin e sanksioneve.

5.3.Liberalizimi i vizave

BE-ja rreth Liberalizimit të Vizave nuk ka qenë korrekt ndaj Kosovës, autoriteteve dhe qytetareve. Edhe gjatë Presidencës Kroate nga fillimi i këtij viti deri në Qershor Kosova shpresonte që do të bëhej ndonjë zgjidhje përfundimtare me Liberalizimin mirëpo, që ende nuk ka një vendim. Republika e Kosovës mbetet e përkushtuar në bashkëpunim dhe shpreson që nën Presidencën Gjermane që të ketë lëvizje në këtë drejtim.

Pa liberalizim po rrënohet kredibiliteti i të gjitha proceseve që kanë të bëjnë me BE-në. Bashkërisht duhet ta tejkalojmë këtë pengesë dhe të evitojmë zbehjen e besimit në BE dhe në orientimin tonë të qartë, sidomos në këto kohëra të vështira sidomos si kjo që po kalojmë së fundmi me ballafaqimin me pandeminë në mbarë botën.

5.4.Rajoni

Fushëveprimi i Departamentit për Marrëdhënie Rajonale (DMR) fokusohet në 3 tema kryesore:

- marrëdhëniet bilaterale me shtetet fqinje dhe në fqinjësi;
- organizatat dhe nismat rajonale;
- zhvillimet në raport me Serbinë.

Sa i përket *marrëdhënieve bilaterale me shtetet fqinje dhe në fqinjësi*, për vitin 2020 dhe në vijim janë planifikuar aktivitete të shumta që janë edhe si vazhdimësi e punës dhe përgatitjeve të kryera më parë.

Theksi duhet vënë te marrëdhëniet me Shqipërinë me të cilën kemi agjendë të veçantë që dallon nga shtetet e tjera. Që nga viti i kaluar janë bërë përgatitje për hapa të rinj që do ta avansonin edhe më tutje raportin mes dy shteteve, ndërkohë që ndër aktivitetet e para do të jenë ato kulturore që do t'i organizojmë së bashku me MEPJ të Shqipërisë gjatë vjeshtës së këtij viti. Gjithashtu, kemi qenë në përgatitje të takimit të përbashkët të dy qeverive, ndërsa tani jemi duke e shqyrtuar mundësinë që për shkak të pandemisë COVID-19.

Kujdes i veçantë i kushtohet edhe marrëdhënieve me Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut. Përderisa janë paralajmëruar takime mes qeverive me këto dy shtete, me Maqedoninë e Veriut është harmonizuar edhe baza e të dhënave që ka të bëjë me marrëveshjet, protokolet, memorandumet dhe nismat e ndryshme ligjore. Në Maqedoninë e Veriut janë mbajtur zgjedhjet e parakohshme parlamentare dhe po e presim formimin e Qeverisë së re për ta intensifikuar bashkëpunimin që e kemi me këtë shtet fqinje; ndërsa në Malin e Zi zgjedhjet parlamentare do të mbahen me 30 gusht dhe jemi të përkushtuar që me të dyja këto shtete ta vazhdojmë bashkëpunimin si në nivel bilateral ashtu edhe në atë multilateral.

Me këtë rast duhet përmendur faktin se për herë të parë që nga shpallja e Pavarësisë së Kosovës një Ministre e Punëve të Jashtme e ka vizituar Luginën e Preshevës. Vizita është realizuar me 9 korrik 2020, dhe gjatë saj është diskutuar për propozime konkrete lidhur me avancimin e bashkëpunimit dhe ndihmës së ofruar për kategoritë e ndryshme të shqiptarëve të Luginës. Gjatë vizitës është bërë thirrje për vazhdim të unifikimit të faktorit politik në Luginë, ndërsa si rezultat vetëm disa ditë më vonë është arritur koalicioni i partive shqiptare për të udhëhequr me Bujanocin pas mbajtjes së zgjedhjeve lokale në këtë qytet. Kemi situatën kur për herë të parë gjenden tre deputetë shqiptarë në Parlamentin e Serbisë, dhe me ta do të mbajmë komunikim të hapur e do ta shfrytëzojmë plotësisht të gjithë potencialin që e kemi për bashkëpunim.

Komunikim i menjëhershëm është vendosur edhe me deputeten e Parlamentit të Republikës së Kroacisë znj. Ermina Lekaj Përlaskaj, pas zgjedhjeve parlamentare të Kroacisë dhe zgjedhjes së saj për herë të tretë si deputete.

Me të gjitha shtetet (njohëse) të cilat mbulohen nga DMR ka komunikim të vazhdueshëm dhe të drejtpërdrejtë. Konsultat politike si mekanizëm i komunikimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve mes shteteve në rajon e kanë vendosur një ritëm të standardizuar me shumicën e shteteve, ndërkohë që plani është që të formalizohet kalendari i tyre deri në fund të 2020. Për shembull, konsultat janë të rregullta (pos në raste të jashtëzakonshme) dy herë në vit me Shqipërinë, Kroacinë, Malin e Zi, ndërsa objektiv është që një ritëm i tillë të vendoset edhe me Maqedoninë e Veriut, Turqinë, Bullgarinë dhe Slloveninë.

Me shtetet jonjohëse marrëdhëniet bilaterale në kuptimin klasik janë të kufizuara, mirëpo shpesh shfrytëzohen forume të ndryshme (rajonale p.sh.), ose përmes prezencës së zyrave ndërlidhëse në dhe të këtyre shteteve për të diskutuar për çështje të ndryshme.

Zyrat ndërlidhëse gjenden në Beograd, Republikën e Serbisë (Misioni i Posaçëm i Republikës së Kosovës në Republikën e Serbisë); dhe në Athinë, Greqi (Zyra për ekonomi dhe tregti). Misioni në Serbi është themeluar në bazë të marrëveshjes së veçantë në kuadër të procesit të Brukselit, ndërkohë që ajo në Athinë vjen si rezultat i komunikimit dhe koordinimit me palën greke.

2) **Organizatat/nismat rajonale** – paraqesin platformën konkrete dhe aktive nëpërmes së cilës Republika e Kosovës e ushtron sovranitetin e saj e barabartë me shtetet e tjera të rajonit. Mënyra e përfaqësimit është e rregulluar përmes “Aranzhimeve lidhur me përfaqësimin dhe bashkëpunimin rajonal” (23 shkurt 2012), në kuadër të procesit të Brukselit.

Duhet theksuar se në vitin 2019 për herë të parë që nga shpallja e Pavarësisë ne kemi kryesuar me nisma rajonale (1 janar 2019-31 dhjetor 2019 Western Balkans Fund WBF dhe RYCO; 1 korrik 2019 – 30 qershor 2020 SEECF dhe MARRI). Kryesimi përkundër mungesës së përvojës të mëparshme ka qenë dhe vazhdon të jetë i suksesshëm, ndërsa si pikë kulminante është prania e të gjithë Ministrave të Punëve të Jashtme dhe përfaqësuesve të tjerë zyrtarë të shteteve anëtare në aktivitetet tona gjatë kryesimit – përfshirë shtetet jonjohëse si Serbia, Bosnjë e Hercegovina, Greqia, Rumania dhe Moldavia.

Proces që tërë konceptit të bashkëpunimit rajonal i ka dhënë një dinamikë dhe dimension plotësisht të ri është Procesi i Berlinit. Ky proces është platforma e vetme rajonale ku Kosova përfaqësohet me flamur dhe emër kushtetues (pra jo në mënyrën e rregulluar përmes “Aranzhimeve...”), dhe në kuadër të kësaj platforme janë mbajtur takime në Prishtinë ku rregullisht marrin pjesë përfaqësues të institucioneve të Serbisë dhe shteteve të tjera jonjohëse nga rajoni. Këtë vit Procesi i Berlinit kryesohet nga Bullgaria dhe Maqedonia e Veriut (për herë të parë bashkëkryesim nga një shtet anëtar i BE-së dhe një shtet nga rajoni).

Kur flasim për nismat dhe organizatat rajonale, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka hyrë në një fazë të re dhe në periudhën para nesh nuk do të mjaftohemi vetëm me pjesëmarrje por do të sigurohemi të kemi rol udhëheqës dhe rrjedhimisht vizibilitet shumë më të madh. Ne jemi në proces të identifikimit të mundësive reale për të marrë kryesimin me ndonjërin nga këto nisma por edhe të shqyrtimit të mundësive që ta kemi edhe selinë e ndonjë organizate në Republikën e Kosovës.

6. DIASPORA

6.1.Gjendja ekzistuese

Sipas PVP 2020 (Plani Vjetor i Punës) deri në fillim të pandemisë COVID-19 janë realizuar aktivitetet e planifikuar për K1 (janar-mars) që kanë të bëjnë me shënimin e Pavarësisë së Republikës së Kosovës në diasporë.

- Shënimi i Pavarësisë së Kosovës është organizuar në bashkëpunim me shoqatat shqiptare në këto vende: Slloveni, Itali, Gjermani, Zvicër, Suedi, Kroaci dhe Turqi.
- Shënimi Pavarësisë është realizuar përmes aktiviteteve kulturore dhe sportive. Kostoja totale është rreth 30,000.00 euro;
- Pas shfaqjes së pandemisë janë pezulluar shumica e aktiviteteve në diasporë. Deri në ndryshimin e kësaj gjendjeje jemi duke punuar në procesin e fuzionimit të dy ministrive.

6.2. Sfidat

Sfidat për vitin 2020 ndërlihen me çështjen e pandemisë dhe pamundësisë së realizimit të shumë aktiviteteve të planifikuar me PVP 2020, si më kryesore:

- Ditët e Diasporës në Kosovë - periudha kohore Qershor - Gusht 2020;
- Ditët e Kulturës në Diasporë - periudha kohore Tetor - Nëntor 2020;
- Dërgimi i librave dhe materialeve tjera shkollore për shkollat (klasave) shqipe në diasporë;
- Organizimi i eskursioneve dhe shkollave verore me nxënësit nga diaspora;
- Organizimin e sesioneve informuese për bizneset e diasporës, forumeve ekonomike dhe takimeve b2b;
- Implementimin e projektit për angazhimin e eksperteve nga diaspora;

Disa nga sfidat që kemi hasur si ish – MeD-së në të kaluarën sidomos me procedurat e prokurimit dhe çështjen e bashkë financimeve, nuk do të jenë më evidente me rastin e bashkimit të dy ministrive për shkak të lehtësirave që ofron ligji për prokurimi publik për MPJD-në.

6.3.Plani afatmesëm

Sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2021-2023 janë planifikuar të realizohen projektet kryesore që lidhen me tri objektivat kryesore të Qeverisë për diasporën, kurse në aspektin legjislativ në vitin 2020 presim miratimin të:

- Projekt-ligjit për Diasporën;
- Projektligji ka kaluar leximin e parë në Kuvendin e Republikës së Kosovës në legjislaturën e kaluar me datë 30.05.2019 i cili mund të ri shqyrtohet;
- Projekt-strategjisë për Diasporën;

- Projekt strategjia është hartuar dhe do të dërgohet për aprovim në Qeveri këtë vit pas disa ndryshimeve teknike për shkak të bashkimit të ministrive;
- Koncept dokumenti për mësimin plotësues në diasporë;
- Ka përfunduar hartimin i Koncept Dokumentit për mësimin plotësues në diasporë përmes të cilit janë analizuar etapat e implementimit të mësimin plotësues në diasporë dhe kostoja e tij e që ndërlidhet me marrëveshjen për organizimin dhe financimin e mësimin të gjuhës dhe kulturës në diasporë me Republikën e Shqipërisë. Për shkak të ndikimit shtesë buxhetor është kërkuar që të dërgohet për ratifikim pas përfundimit të koncept dokumentit;
- Koncept dokumenti për lehtësimin e investimeve të diasporës në Kosovë;
- Është hartuar draft i parë dhe këtë vit do të dërgohet për aprovim në Qeveri;
- Themelimi i Këshillit Konsultativ të Diasporës; Këshilli ka karakter konsultativ dhe ka për synim që përmes këshillave në diasporë të themelohet një këshill kombëtar që ka përgjegjësi dhënien dhe propozimin e politikave për diasporën në kuadër të institucioneve të Republikës së Kosovës;
- Hapja e Qendrave Kulturore në diasporë; Ish Ministria e Diasporës ka themeluar tri Qendra Kulturore, në Turqi, Zvicër dhe Suedi të cilat funksionojnë, sipas vendimit Nr. 05/153 i datës 25.10.2013 të Qeverisë së Republikës së Kosovës parashihet themelimi i qendrave në: Gjermani, Austri, Francë, ShBA. Por sipas Marrëveshjes së nënshkruar me Republikën e Shqipërisë me datë 27.11.2017 parashihet të themelohen qendra te përbashkëta mes dy shteteve me financim të barabartë. Kjo marrëveshje do të dërgohet për ratifikim pas shqyrtimit të kostos shtesë buxhetore;
- Vazhdimi i themelimit të rrjeteve të profesionistëve; Do të vazhdohet themelimi i rrjeteve të juristëve në diasporë, mjekëve, studentëve, bizneseve, etj.

7. ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE

7.1.Hyrje

Në funksion të forcimit të subjektivitetit të vendit, si dhe të krijimit të mundësive zhvillimore nëpërmjet ndërveprimit dhe bashkëpunimit multilateral në nivel rajonal dhe global në fushat me interes për vendin, integrimi ndërkombëtar nëpërmjet anëtarësimit në organizata shumëpalëshe rajonale dhe ndërkombëtare si dhe avancimi i hapësirave të bashkëpunimit në ato ekzistuese ku tashmë jemi anëtar, mbetet një ndër objektivat strategjike të politikës së jashtme të Republikës së Kosovës.

7.2.Gjendja ekzistuese

Republika e Kosovës është anëtare në 106 organizata ndërkombëtare, rajonale, konventa dhe mekanizma të tjerë multilateralë si dhe 34 organizata sportive.

Në gjashtë mujorin e parë janar-qershor 2020 është realizuar me sukses anëtarësimi respektivisht aderimi në këto organizata/konventa:

- **Anëtarësimi në INTOSAI:** Anëtarësimi në këtë organizatë (Unioni Ndërkombëtar i Institucioneve të Larta të Auditimit) promovon rritjen e cilësisë dhe kompetencave të institucioneve të larta të auditimit si dhe qeverisjen e mirë, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies si dhe ngritjen e kompetencës profesionale. **Konfirmimi i zyrtar i anëtarësimit me 31 janar 2020.**
- **Anëtarësimi në Komitetin Ndërkombëtar për Regjistrimin e Kafshëve (International Committee for Animal Recording)** - organizatë ndërkombëtare që siguron një rrjet të hapur që ka për qëllim të stimulojë prodhimin e produkteve me origjinë shtazore në të gjithë botën, duke siguruar dhe cilësi dhe siguri maksimale për konsumatorët;
- **Konfirmimi zyrtar i anëtarësimit me 31 janar 2020.**
- **Aderimi në konventën Ndërkombëtare mbi Harmonizimin e Përshkrimit të Mallrave dhe Sistemit të Kodimit Doganor të Organizatës Botërore të Doganave** (e ashtuquajtur "Konventa HS") - Qëllimi i Konventës HS është të lehtësojë tregtinë dhe shkëmbimin e informacionit duke harmonizuar përshkrimin, klasifikimin dhe kodimin e mallrave në tregtinë ndërkombëtare. **Shpallja formale aderimit është dashur të bëhet në mars 2020 në takimin e Komitetit, por për shkak të mos mundësisë së mbajtjes së takimit si rezultat i pandemisë është shtyrë, mirëpo Doganat e RKS-së, tashmë janë zyrtarisht të përfshira në të gjitha aktivitetet e Konventës.**
- **Aderimi në Konventën Ndërkombëtare mbi Thjeshtëzimin dhe Harmonizimin e procedurave ligjore të Doganave të Organizatës Botërore të Doganave**(e ashtuquajtur **Konventa e rishikuar e Kiotos**) - është konventa kryesore për lehtësimin e procedurave doganore për tregtinë. Synon lehtësimin e tregtisë ndërmjet vendeve anëtare duke harmonizuar dhe thjeshtuar procedurat dhe praktikatat doganore. **Konfirmimi i zyrtar i aderimit shkurt 2020.**

Anëtarësimet në proces:

- **IDLO -International Development LAW Organisation:** MPJD-ja, ka përfunduar të gjitha veprimet e nevojshme për të përmbyllur procesin e anëtarësimit në këtë organizatë, duke përfshirë sigurimin e mbështetjes (votave) si dhe përmbylljen e aspektit procedural. Për momentin, pritët nga Ambasada e RKS-së në Romë të fillojë koordinimin me sekretariatën e organizatës, të cilët kanë

pezulluar veprimtarinë për shkak të gjendjes së krijuar në Itali si pasojë e pandemisë.

- **EURIMAGES**-Pas aprovimit të nismës për anëtarësim në EURIMAGES nga Qeveria e RKS, me iniciativë të Ministrinë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, MPJD ka paraqitur kërkesën formale për anëtarësim Sekretares së Përgjithshme të Këshillit të Evropës, në prill 2020. EURIMAGES është mekanizëm që funksionon në kuadër të Këshillit të Evropës, i cili ka për qëllim promovimin e krijueseve të pavarur të filmit, duke iu ofruar ndihmë financiare për filmat artistikë, dokumentarë dhe të animuar dhe nëpërmjet kësaj inkurajon bashkëpunimin në mes të profesionistëve nga vende të ndryshme.

7.3.Sfidat

Kontestimi i vazhdueshëm i subjektivitetit ndërkombëtar të RKS-së, nga ana e Serbisë dhe vendeve mbështetëse të saj, si Rusia dhe Kina si dhe ndikimi i tyre i drejtpërdrejt në pamundësimin e anëtarësimit në OKB, në vazhdimësi kanë vështirësuar dhe në raste pamundësuar integrimin ndërkombëtar të Kosovës.

Plani afatmesëm: Inicimi i proceseve të reja të anëtarësimit të parashikuara për vitin 2020 -2021 në organizata ndërkombëtare, rajonale dhe mekanizma të tjerë shumëpalësh, si dhe avancimi i hapësirave të bashkëpunimit në ato ekzistuese ku tashmë jemi anëtarë:

Këshilli i Evropës

Anëtarësimi në KiE vazhdon të mbetet një nder synimet e rëndësisë së veçantë për vendin, jo vetëm si projektion i nevojës së institucioneve të Kosovës për të riafirmuar pozitën e Kosovës në organizatat shumëpalëshe, por edhe për t'i siguruar qytetarët e Kosovës me instrumente kyçe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Nisur nga kjo, dhe me qëllim të përmbylljes së këtij procesi, MPJD-ja, ka hartuar strategjinë dhe planin e veprimit që mundëson një kornizë të strukturuar të procesit që i paraprinë anëtarësimit, si dhe ka koordinuar në vazhdimësi veprimet dhe siguruar mbështetjen nga vendet partnere për anëtarësim.

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH)

Anëtarësimi në OBSH, përveç që do të ketë ndikim politik në konsolidimin e mëtejshëm të shtetit të Kosovës në marrëdhëniet multilaterale (anëtarësimi eventual do të çonte në 3 numrin e Agjencive të Specializuara të OKB-së ku Kosova është anëtare), mbi të gjitha, ky hap është i rëndësisë së veçantë për shkak se do të ndikonte në mënyrë të drejtpërdrejt në forcimin e sistemit shëndetësor në RKS.

Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO)

Organizata Botërore e Aviacionit Civil është krijuar me *Konventën për Aviacionin Civil Botëror*, të nënshkruar në Chikago më 7 dhjetor 1944. Kjo konventë e njohur edhe si “Konventa e Chikagos” është instrument shumëpalësh që për momentin aplikohet në 191 shtete.

Konventa është një kodifikim i rregullave bazike të së drejtës ndërkombëtare në fushën e aviacionit civil, e për më shumë, Konventa është gjithashtu instrument themelues në bazë të cilit ICAO është krijuar dhe funksionon.

Konventat dhe Protokollet e Gjenevës

Në vitin 2019 u ndërmorën hapat e parë në diskutim me vendet anëtare për sigurimin e mbështetjes për aderim në konventat e Gjenevës.

Organizata Ndërkombëtare e Frankofonise-Avancimi i statusit nga vend anëtar i asocuar në vend anëtar me të drejta të plota.

Republika e Kosovës u anëtarësua në Organizatën Ndërkombëtare të Frankofonisë si anëtare vëzhguese në Samitin e Dakarit në nëntor të vitit 2014, ndërsa në Samitin e Erevanit më 11 tetor 2018 e avancoi statusin e saj si anëtare e asociuar në këtë organizatë.

Nisur nga kjo dhe duke pasur parasysh që ON e Frankofonise është një ndër organizatat më të rëndësishme sa i takon ndërveprimet të Kosovës me një numër të madh shtetesh frankofone, është parashikuar të vazhdohet me aktivitete që kanë për qëllim promovimin e frankofonisë dhe përafrimin me vendet frankofone, me qëllim të fuqizimit të pozitës së RKS në këtë organizatë dhe në të njëjtën kohë të përmbushen objektivat të cilat konsiderohen si kritere për avancim të statusit nga anëtar i asociuar në anëtar me të drejta të plota.

Asambleja e Përgjithshme e Frankofonise - Avancimi i statusit nga vend vëzhgues në anëtar me të drejta të plota.

Kuvendi i Kosovës, u anëtarësua në cilësi të vëzhguesit në Asamblenë Parlamentare të Frankofonisë (APF) në qershor 2018 në Kanada.

Tashme kane filluar përgatitjet për avancimin e statusit, është mbajtur takimi i parë në nëntor të 2019, dhe është realizuar vizita në Kosovë e Sekretarit të Përgjithshëm dhe përgjegjësit për Evropë për t'i diskutuar aspektet procedurale për fillimin e aktiviteteve për avancimin e statusit.

Organizata botërore e Doganave-OB

Vazhdimi i koordinimit me vendet partnere për parandalimin e kontestimit të anëtarësimit të RKS në këtë organizatë si dhe fuqizimin e mëtejshëm të pozitës së RKS brenda organizatës.

Aktivitetet e MPJD në kuadër të Komitetit për Koordinimin dhe Vlerësimin e Situatës Emergjente Covid-19 në Kosovë

MPJD në kuadër të Komitetit për Koordinimin dhe Vlerësimin e Situatës Emergjente me Covid-19 është angazhuar në sigurimin e donacioneve për të lehtësuar përballjen e institucioneve shëndetësore të Kosovës me COVID-19.

Në këtë kuadër, deri më sot janë siguruar donacione emergjente për institucionet e shëndetësisë si dhe ato socio-ekonomike dhe makro-fiskale të cilat po e ndihmojnë sistemin shëndetësor në përballjen me pandeminë, si dhe të njëjtat do të ndikojnë në zbutjen e pasojave ekonomike të shkaktuara nga pandemia.

8. DIPLOMACIA EKONOMIKE

8.1.Gjendja Ekzistuese

Misioni i MPJD në fushën e Diplomacisë Ekonomike, ka të bëjë me promovimin e interesit ekonomik kombëtar të Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare, sensibilizimin dhe tërheqjen e investimeve të huaja në sinergji me programin e zhvillimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në kuadër edhe të politikave të integritit në BE. Që nga themelimi i MPJD, misionet e Kosovës jashtë kanë qenë të obliguara që të angazhojnë njërin nga diplomatët me çështje të Diplomacisë Ekonomike, megjithatë, për të ri-aktualizuar këtë detyrim, në maj të viti 2019, MPJD ka dërguar një Urdhëresë në të gjitha misionet e RKS-së, për të kërkuar caktimin e një diplomati përgjegjës për Diplomaci Ekonomike me përshkrimin e detyrave specifike që duhet t'i përmbahen. Deri më tani, MPJD-ja, ka 38 diplomatë përgjegjës për Diplomaci Ekonomike.

Nxitja e Investimeve: MPJD-ja, ka fokus të veçantë investimet që rrjedhin nga diaspora dhe krijimi i kushteve dhe hapësirës në këtë drejtim. Si proces i zhvilluar qysh më herët dhe që ka vazhduar deri në shkurt 2020, janë dhe Sesionet Informuese (SI) të organizuara nga MPJD, KIESA, ME, dhe akterët e tjerë të rëndësishëm për njoftimin e diasporës me mundësitë e investimit në RKS. MPJD-ja, ka transformuar punën e SI, nga prezantime teorike, në pjesëmarrje të vet bizneseve për prezantimin e punës së tyre (*shembull: SI në Mynih 2019 në gjysmën e dytë të viti 2019, ku kanë marrë pjesë rreth 8 përfaqësues të vreshtarisë për të prezantuar punën e tyre*).

Për gjysmën e dytë të viti 2019 janë organizuar 4 aktivitete ekonomike: 3 Sesione Informuese: New York, Munich dhe Bern, dhe 1 Forum Ekonomik në Dubai, me qëllim të promovimit të investimeve dhe stimulimit të eksportit të produkteve të RKS-së. Ndërsa planifikimet për mbajtjen e SI në Bruksel, Berlin dhe Vjenë, janë anuluar për shkak të fillimit të pandemisë.

Promovimi Ekonomik: përmes misioneve të RKS, MPJD furnizon vazhdimisht misionet tona me materiale promovuese, duke përfshirë shpesh dhe dërgimin e produkteve ushqimore si: lëngje alkoolike dhe joalkoolike, produkte të tryezave etj., për të mundësuar prezantimin e materialeve promovuese në pjesëmarrjen në forume ekonomike, si dhe praktikon dërgimin e raporteve javore me informata për zhvillim ekonomik, fletushkave për mundësitë e investimeve në RKS dhe kalendarin vjetor të ngjarjeve ekonomike të cilin e ndanë me të gjithë akterët në RKS për të inkurajuar pjesëmarrjen sa më të gjerë të bizneseve të RKS-së.

Bashkëpunimi Bilateral: sa i përket formalizimit të bashkëpunimit bilateral ekonomik, MPJD-ja vazhdimisht asiston dhe nxitë nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale për promovimin dhe mbrojtjen e investimeve dhe marrëveshjeve bilaterale për bashkëpunim ekonomik.

Së fundmi departamenti për Diplomaci Ekonomike ka përgatitë një listë të të gjitha marrëveshjeve bilaterale ekonomike dhe gjithashtu ka kërkuar informacion nga misionet tona diplomatike dhe konsullore për marrëveshjet të cilat janë iniciuar por kanë ngecur me procedura.

Aktualisht janë rreth 76 marrëveshje me karakter ekonomik në mes të Republikës së Kosovës dhe shteteve tjera. Prej këtyre marrëveshjeve janë të nënshkruara 7 Marrëveshje për Bashkëpunim Ekonomik, këto marrëveshje janë të lidhura me: Republikën e Sllovenisë, Republikën e Kroacisë, Republikën e Maqedonisë së Veriut, Emiratet e Bashkuara Arabe, Republikën e Turqisë, Republikën e Çekisë dhe Republikën e Hungarisë.

Ndërsa, Marrëveshje për Promovimin dhe Mbrojtjen e Investimeve janë nënshkruar gjithsej 8 marrëveshje me këto shtete: Rep. e Austrisë, Belgjika, Emiratet e Bashkuara Arabe, Rep. e Kanadasë, Luksemburgu, Rep. e Shqipërisë, Rep. e Turqisë, Rep. e Zvicres.

8.2.Sfidat

Sfida kryesore e Diplomacisë Ekonomike mbetet pandemia. Ashtu siç ka ndikuar kjo situatë në të gjithë globin - ajo është duke e dëmtuar shumë edhe Diplomacinë Ekonomike të shtetit tonë, ku si rezultat janë ndërprerë shumë aktivitete të cilat kanë qenë të planifikuara të ndodhin këtë vit dhe përmes tyre të promovohet ekonomia e Kosovës.

Disa nga ngjarjet që janë ndërprerë apo mbesin në pritje si pasojë e pandemisë janë:

- Forumi Ekonomik Kosovë- Greqi;
- Forumit Ekonomik Kosovë-Kroaci;
- Komisionet e përbashkëta ekonomike me Çekinë dhe Hungarinë;
- Sesione informuese në Austri, Belgjikë dhe Gjermani ;
- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet OCC (Ontario Chamber of Commerce) me OEK (Oda Ekonomike e Kosovës);
- Vizita të shumta të njerëzve të profileve dhe fushave të ndryshme, si përfaqësues të odave ekonomike, ndërmarrës, afaristë, gazetarë etj. nga shtetet si, Suedia, Gjermania, Japonia etj. Ku qëllimi i këtyre vizitave ishte hulumtimi i mundësive për bashkëpunim ekonomik në mes Kosovës dhe këtyre shteteve.

8.3.Plani afatmesëm

Departamenti për Diplomaci Ekonomike ka vendosur 4 objektiva në kuadër të Planit Punës për gjysmën e dytë të vitit 2020 dhe gjysmën e parë të vitit 2021. Realizimi i disa nga objektivat e poshtëshënuara do të varet nga zhvillimi i situatë pandemike.

Objektivi I. Avancimi i diplomacisë ekonomike dhe fuqizimi i mëtutjeshëm i shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës.

- Nxitja e investimeve të huaja, nxitja e eksportit, thellimi i bashkëpunimit ekonomik ndër-shtetëror.
 - Sesionet Informuese me diasporë dhe promovimi i investimeve në Kosovë;
 - Evidentimi distributorëve të prodhimeve nga Ballkani dhe kapacitet importuese të vendeve ku shërbejnë
 - Furnizimi me materiale promovuese në bashkëpunim të ngushtë me KIESA;
 - Komisionet ndër-shtetërore për bashkëpunim ekonomik (R. Ceke, Sllovenia, Turqia, etj.)
- Pjesëmarrja e Institucioneve dhe Sektorit Privat në evente ekonomike ndërkombëtare:
 - Përgatitja e RKS për pjesëmarrje në Forumin kryesor ekonomik që është EXPO Dubai 2021;
 - Shpërndarja e kalendarit vjetor të forumeve dhe panairove ekonomike në botë, me institucionet dhe bizneset vendore;

- Facilitimi i pjesëmarrjes së bizneseve të KS në forume të ndryshme për promovim të produkteve të Kosovës
- Bashkëpunimi ndër-institucional:
 - Diskutimi me Institucionet vendore për koordinim më të mirë të aktiviteteve Ekonomike;
 - Pjesëmarrja në takimi të Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik Kombëtar.

Objektivi II.

Hartimi i Udhëzuesit për Diplomaci Ekonomike

- Bashkëpunimi ndër-institucional për hartimin e Udhëzuesit për Diplomaci Ekonomike (MPJD deri më tani nuk ka pasur dokument strategjik mbi zhvillimin e Diplomacisë Ekonomike që nga viti 2015).

Objektivi III.

Avancimi i bashkëpunimit ndër-shtetëror përmes lidhjes së marrëveshjeve ekonomike

- Nga evidentimi i fundit për nismat e inicuar, del të kemi gjithsej 43 marrëveshje të inicuar të cilat priten të vazhdojnë procedurat në gjysmën e dytë të vitit 2020 dhe gjatë vitit 2021;
- Identifikimi i shteteve më të cilat nuk kemi marrëveshje ekonomike (të shikohen marrëveshjet me Francë).

Objektivi IV.

Ngritja e kapaciteteve profesionale

- Vizita profesionale: Pjesëmarrja dhe përfaqësimi në simpoziume/konferenca ndërkombëtare dhe pjesëmarrja në trajnime;
- Organizimi i trajnimeve për diplomatë të ngarkuar me përgjegjësi për diplomaci ekonomike.

9. DIPLOMACIA DIGJITALE DHE PUBLIKE

9.1.Hyrje

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diaspora e Republikës së Kosovës do të zhvillojnë një qasje në tre nivele në komunikimin ndërkombëtar përmes:

- a) diplomacisë publike,
- b) diplomacisë digjitale,
- c) komunikimit strategjik dhe kundërveprimit të dezinformimeve.

Diplomacia Publike është një proces i vazhdueshëm dhe duhet të trajtohet si e tillë. Kosova nuk mund të përballojë të përfundojë përpjekjet e saj me opinionin publik ndërkombëtar.

Si një vend i vogël, ajo ka nevojë për përpjekje të vazhdueshme, inovative dhe gjithëpërfshirëse për të arritur audiencë të ndryshme në të gjithë botën. Kosova duhet të fillojë një përpjekje masive të diplomacisë publike, dhe ne duhet të punojmë me vende dhe rajone të ndryshme, aktorë të ndryshëm dhe institucione të larta të politikës së jashtme për të lehtësuar një kuptim më të madh të Kosovës në proceset globale, dhe anasjelltas.

Diplomacia Digjitale është një mjet kyç për të mbështetur njohjen e Kosovës dhe për të siguruar informacion të saktë dhe pozitiv nga dhe rreth Kosovës. Diplomacia digjitale është një mjet jetësor nëse Kosova dëshiron të ndërtojë pozicionin e saj ndërkombëtar për të bindur përfundimisht vendet që nuk njohin të ndryshojnë qëndrimin e tyre aktual, të përmirësojnë perceptimin e përgjithshëm të Kosovës dhe të promovojnë potencialin ekonomik, njerëzor dhe kulturor të Kosovës. Kjo kërkon një përpjekje afatgjatë dhe të qëndrueshme, e integruar në shpërndarjen e mediave dhe komunikimit më të gjerë si në Prishtinë, në ambasadat e Kosovës jashtë shtetit, dhe vendet ku aktualisht nuk mund të ketë prezencë diplomatike.

Dezinformimi është një kërcënim në zhvillim i cili kërkon përpjekje të vazhdueshme për të adresuar aktorët, vektorët, mjetet, metodat, objektivat dhe ndikimin me përparësi. Lufta kundër dezinformatave dhe fushatave propagandistike që kryesisht orkestrohen nga Serbia, Rusia dhe vendet e tjera të treta duhet të jenë pjesë e qasjes strategjike të komunikimit të Kosovës.

9.2.Qëllimi

Kosova duhet të përqendrojë diplomacinë e saj publike dhe digjitale dhe qasjen e komunikimit strategjik në narrativat e mëposhtme:

Njohja ndërkombëtare e Kosovës si shtet nga 5 anëtarë të BE-së dhe vende të tjera. Synimi i vazhdueshëm i Kosovës për t'u bërë anëtare e organizatave ndërkombëtare duke treguar nevojat teknike të secilit synim anëtarësie, në shëndetësi, bashkëpunim policor, të drejta të njeriut, tregti, etj,

Promovimi i talentëve të Kosovës në sporte, kulturë, arte dhe fusha të tjera, si pjesë e promovimit të talenteve të Kosovës jashtë vendit.

Për të promovuar historinë e lirisë së Kosovës, dhe luftën për çlirim dhe për t'u bërë një shtet modern demokratik. Kosova duhet të ndërmarrë veprime serioze kundër përpjekjeve për të fshehur dhe mohuar krimet e luftës që Serbia ka kryer në Kosovë.

Kundërshtimi i fushatave dezinformuese dhe propaganduese nga Serbia, Rusia, dhe aktorë të tjerë duke promovuar kundër-narracion dhe storie pozitive për Kosovën jashtë, por

gjithashtu duke marrë një perspektivë të orientuar drejt aspektit sigurisë për kërcënimet ndaj shtetësisë së Kosovës dhe mënyrës së jetesës nga fushatat dizinformative.

Promovimi i investimeve në Kosovë dhe forcimi i potencialit të Kosovës për tregti përmes aktiviteteve dhe veprimeve promovuese.

9.3.Sfidat

Kosova përballlet me një sërë sfidash unike në lidhje me sferën digjitale. Si një vend i ri që ka arritur njohjen nga 116 shtete në ekzistencën e saj 12-vjeçare, anëtarësimi në OKB është një qëllim afatgjatë për Kosovën.

Imazhi i Kosovës po pengohet gjithashtu nga propaganda e qëllimshme, perceptimi i ritmit të ngadaltë të reformave në Kosovë, paragjykimet e vjetra si dhe mungesa e përmbajtjes digjitale pro-aktive me origjinë nga Kosova.

9.4.Qasja

Përfshirja e diasporës si pjesë përbërëse e strukturave të Diplomacisë Publike dhe qasjes jashtë vendit është thelbësore.

Përfshirja e sektorit privat është po aq e rëndësishme. Sektori privat ka fleksibilitetin, burimet njerëzore dhe kapitalin për të mbështetur përpjekjet e Diplomacisë Publike jashtë vendit, pasi kompanitë shpërthejnë në tregjet e huaja me produktet e tyre. Kombinimi i përpjekjeve të tyre do të përfitonte si Qeveria ashtu edhe sektori privat. Kjo do të lidhë diplomacinë publike me synimet e promovimit të investimeve në Kosovë.

Kosova duhet të jetë pjesë e infrastrukturës globale të internetit - kjo kërkon një përpjekje të koordinuar të lobimit ndërkombëtar.

Është e rëndësishme të monitorohet dhe shtyhet përmbajtja në internet në faqet e internetit të jashtme, veçanërisht nëse kjo është ajo ku audienca e synuar ka më shumë të ngjarë të ketë informacion në lidhje me Kosovën.

Diplomacia Digjitale duhet të jetë pjesë e një qasje strategjike dhe të integruar ndaj komunikimit në institucionet e Kosovës. Zyra e Presidentit, Zyra e Kryeministrit, Kuvendi, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diaspora, Ministrinë dhe Agjencitë të tjera duhet të krijojnë një bord joformal të komunikimit strategjik i cili do të koordinonte qasjen e komunikimit strategjik të Kosovës.

Rritja e ndikimit digjital të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrive që merren me punët e jashtme (Tregtia, Diaspora, Investimet, integrimet në BE). Kosova duhet të veprojë me një zë të vetëm dhe një narrativë.

10. MARRËVESHJET SOFA

10.1. Gjendja e marrëveshjeve SOFA

Marrëveshja mbi statusin e forcave (SOFA) - është një marrëveshje standarde që përkufizon statusin ligjor të personelit ushtarak në një vend të huaj. Republika e Kosovës ka të nënshkruar këtë marrëveshje me ShBA-të(2012) dhe me Shqipërinë (2013), në të cilat përcaktohen përgjegjësitë e personelit ushtarak, si dhe mbështetet bashkëpunimi aktual dhe një partneritet për të çuar përpara sigurinë e popullit të Kosovës dhe të kontribuojë në stabilitetin dhe paqen në Ballkan.

MPJD në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes, ka iniciuar procedurën edhe për pjesëmarrje në operacione paqeruajtëse në Republikën Islamike të Afganistanit, Republikën e Irakut dhe Shtetin e Kuvajtit. Zbarkimi i FSK-së në këto vende do të duhej të realizohet si pjesë e bashkëpunimit me ShBA-të, respektivisht me Gardën Kombëtare të shtetit të Iowa-s, me të cilën Republika e Kosovës ka partneritet strategjik në fushën e bashkëpunimit të sigurisë.

Me Afganistan janë zhvilluar kontaktet e para, por pas njoftimit për tërheqje nga Garda Kombëtare e Iowes nga pjesëmarrja në mision paqeruajtës në këtë vend, procesi i SOFA-s momentalisht është pezulluar, megjithëse komunikimet mes Ambasadës sonë dhe të Kuvajtit në Turqi janë duke vazhduar. Me Kuvajt janë dërguar kërkesat zyrtare për inicim të SOFA-s dhe është duke vazhduar komunikimi mes Ambasadës sonë dhe të Kuvajtit në Shqipëri, ndërsa janë dërguar edhe kërkesat për takime (virtuale) në mes të Ministrave të Jashtëm të RKS dhe Kuvajt. Sa i përket Irakut, janë zhvilluar bisedimet preliminare me diplomatë dhe zyrtarë të Irakut. Me rastin e emërimit të ministrit të ri të jashtëm irakian, në fillim të korrikut është nisur letër urimi me theks në gatishmërinë e RKS për bashkëpunim dhe kontribut për paqe dhe stabilitet në rajon.

10.2. Sfidat në nënshkrimin e marrëveshjeve SOFA

- Nga misionet tona është bërë me dije se situata aktuale me pandeminë është duke ndikuar në prolongimin e procesit të marrëveshjeve, pasi që ndikon në zgjatjen e kohës për vendimmarrje.
- RKS është në pritje të ndryshimit eventual të vendimit të Gardës së Iowes për pjesëmarrje në mision paqeruajtës në Afganistan, meqë këtë mision nuk mund ta realizojë e vetme.
- Iraku ende nuk e ka njohur Republikën e Kosovës dhe ka pasur ndryshim të Qeverisë në muajt e fundit.

10.3. Rekomandimet

- Përballë ngecjeve të mëtutjeshme, të kërkohet mbështetja e Departamentit të Shtetit (SHBA). Në këtë drejtim mund të angazhohet edhe ambasada jonë në Washington.
- Të insistohet nga Ambasadat tona që të organizohen takimet virtuale mes Ministrës sonë të Jashtme dhe Ministrave të Jashtëm të Kuvajtit dhe Irakut.

I. PËRFUNDIME

Duke pasur parasysh gjendjen në të cilën është gjetur MPJD-ja, shërbimi i jashtëm dhe politika e jashtme, duhet të ri theksohet që Ministrja e MPJD-së, me rastin e marrjes së detyrës së saj është përballur me problemet më elementare organizative, brenda kabinetit dhe MPJD-së në përgjithësi. Shumë dokumente që kanë munguar është dashur të gjinden në kanalet tjera. Nuk ka pasur asnjë raport, apo dokument memorie, e cila është lënë nga ish Ministri Konjufca. Po ashtu gjendja në politikën e jashtme dhe pasojat e veprimeve të Qeverisë Kurti kanë qenë mjaft të ndjeshme në politikën e jashtme. Në këtë aspekt, Ministrja e MPJD-së, me të marrë detyrën është dashur të përballlet me efektet e këtyre veprimeve, respektivisht parandalimin e dy ç ‘njohjeve.

Është punuar në mënyrë intenzive në rikuperimin e pasojave të veprimeve të Qeverisë së kaluar, në raport me Serbinë, veprime këto të cilat kanë shkaktuar pasoja të mëdha në pozitën ndërkombëtare të Kosovës.

Po ashtu është dashur të punohet në mënyrë intenzive për rivendosjen e raporteve më Shtetet e Bashkuara të Amerikës, raporte këto që me veprimet e qeverisë Kurti ishin dëmtuar dhe po ashtu kishin dëmtuar edhe pozicionin ndërkombëtar të Kosovës. Është punuar fuqishëm për rikuperimin e regresit që është bërë në raport me NATO-n.

Ministrja Meliza Haradinaj-Stublla ka pasur telefonata të shumta me homologët e saj në shtetet e ndryshme të botës. Është punuar intenzivisht në aspektin e brendshëm dhe atë në disa dimensione siç janë: kthimi i ligjshmërisë në MPJD; Riorganizimi dhe reforma në shërbimin e jashtëm; finalizim në mënyrë të suksesshme e procesit të rotacionit duke ruajtur funksionalitetin e shërbimit të jashtëm dhe duke vlerësuar nevojat reale që ka ky shërbim.

Do të vazhdohet me finalizimin e të gjitha proceseve të nisura. Ndër prioritetet e Ministres Meliza Haradinaj Stublla janë: Forcimi i pozicionit të Republikës së Kosovës në politikën e jashtme; Thellimi i bashkëpunimit me NATO-n; Reforma legjislativë dhe riorganizimin në shërbimin e jashtëm si dhe draftimin dhe fillimi i zbatimit të procesit të vetingut diplomatik në shërbimin e jashtëm etj.

